PJESA E PARË

ANA SHPIRTËRORE E HAXHIT

Lavdi dhe falënderime të panumërta i qofshin Allahut (xh.sh.), i Cili na tregoi rrugën që na çon tek Ai, duke na bërë fatlumë me begatinë e ndjenjës së besimit dhe të adhurimit. Përshëndetjet më të sinqerta i dërgojmë Profetit Muhamed (a.s.), Dritës së Gjithësisë, udhërrëfyesit të gjithë njerëzimit, i cili është shembulli dhe modeli më i bukur, që të shpie në rrugën e Allahut (xh.sh.).

PËRSHKRIMI DHE RËNDËSIA E HAXHIT

Haxhi ka kuptimin e të synuarit, të orientuarit. Haxh quhet të vizituarit e një numri vendesh të caktuara brenda një hapësire kohore të caktuar, sipas disa rregullave të caktuara; çka pohohet se përkon, në ditë të caktuara të vitit, pas hyrjes në ihram me nijetin e kryerjes së haxhit, me të ndalurit në Arafat dhe me të kryerit e tavafit në Qabe. Ihrami është kusht i haxhit, ndërsa të ndalurit dhe tavafi janë ruknet (shtyllat) e tij.

Riteve që kryhen në haxh, me një shprehje të përgjithshme, u thuhet "Menasik", ndërsa ai që e zbaton këtë ritual quhet "haxhi".

Haxhi, si një ndër pesë kushtet themelore të Islamit, është caktuar si farz në vitin 9 të hixhretit. Të qenit e haxhit farz është bërë i ditur në Kur'anin fisnik dhe në sunet. Në lidhje më këtë konkludim, myslimanët janë në një mendje (ixhma).

Në Kur'an është urdhëruar e thënë: **"Vizita e Shtëpisë së Allahut, për këdo që ka mundësi, është e drejtë e Allahut ndaj tij." (Ali Imran 3/97)**

Profeti ynë (paqja qoftë mbi të) në një hadith na ka urdhëruar: "Pa dyshim, Allahu jua ka bërë detyrim haxhin, ndaj kryejeni atë."[1]

Ndërsa një tjetër hadith pohon: "Islami ngrihet mbi pesë shtylla. Këto janë: të dëshmosh se nuk ka Zot tjetër përveç Allahut dhe se Muhamedi është i Dërguari i Allahut, të falësh namazin, të mbash agjërimin, të japësh zekatin dhe të kryesh haxhin." Kështu, Profeti e ka cilësuar haxhin si një ndër pesë kushtet themelore të Islamit dhe ka treguar personalisht në mënyrë praktike se si duhet bërë ai.

Kur Profeti ynë (paqja qoftë mbi të) u bëri të ditur sahabëve fisnikë bërjen farz të haxhit, njëri prej tyre pyeti: "Çdo vit?" Profeti heshti. Kur kjo pyetje u përsërit tri herë, ai u përgjigj: "Nëse do të thosha po, haxhi do t'ju bëhej i detyruar për çdo vit dhe ju për këtë nuk do të kishit mundësi."[2]

Në transmetimin e këtij hadithi përmes ibn Abasit (r.a.), në fund të rivajetit shtohet kjo shprehje: "Për këdo që kryen më shumë se një haxh, kjo është nafile."[3]

Çdo mysliman, qoftë burrë apo grua, që plotëson kushtet përkatëse, pra që ka mundësitë shëndetësore dhe financiare për të kryer haxhin, të paktën një herë në jetën e tij duhet ta çojë në vend këtë detyrim. Riti i haxhit, sapo të krijohen mundësitë, duhet të përmbushet pa vonesë. Çdo mysliman që e ka kryer haxhin një herë në jetën e tij, llogaritet ta ketë kryer këtë detyrim.

Kryerja e haxhit pa u vonuar, krahas ajeteve përkatëse, që shërbejnë si argument, theksohet edhe prej këtyre haditheve: "Nxitoni të shkoni në haxh, sepse askush prej jush nuk mund ta dijë se kur do t'i vijë vdekja."[4]

---

1. Muslim, Haxh, 412; Nesai, Menasik, 1.

2. Muslim, Haxh, 412; Nesai, Menasik, 1.

3. Ibn Hanbel, II, 508; Nesai, Menasik, 1.

4. Ebu Davud, Menasik, 5; Ibn Maxhe, Menasik, 1.

Rituali i haxhit, në formën e tij të njohur, është një ibadet që na mbërrin që nga koha e Ibrahimit (a.s.). Kur'ani fisnik, në ajetet 22/27–28 të sures "Haxh", bën fjalë për haxhin e Ibrahimit, për thirrjen e drejtuar prej tij njerëzve për të marrë pjesë në haxh, për historinë e Qabesë e të riteve të haxhit.

MIRËSIA E HAXHIT

Haxhi ka plot dobi vetjake dhe shoqërore. Më kryesoret janë këto që vijojnë: haxhi mundëson që individit t'i falen mëkatet dhe zemra e tij të pastrohet prej tyre. Profeti i nderuar (paqja qoftë mbi të) në një hadith të tij thotë: "Kushdo që për hir të Allahut bën haxh dhe u shmanget fjalëve dhe sjelljeve të pahijshme e nuk përlyhet prej mëkatesh, kthehet i pastruar prej mëkateve sikur të ketë lindur prej nënës."[5] Në të tjera hadithe të tij, ai thotë: "Shpërblimi i haxhit të pranuar nuk është asgjë tjetër veç xhenetit", "Edhe në umre, pastrohen mëkatet e kryera në kohën që ndan njërën umre nga tjetra."[6]

Pyetjes "Cila nga veprat është më e mira?", Profeti ynë i është përgjigjur: "Besimi tek Allahu dhe tek i Dërguari i Tij." I pyetur: "Po më pas?", është përgjigjur: "Xhihadi në rrugën e Allahut". I pyetur sërish: "Po më pas?", ka urdhëruar e ka thënë: "Haxhi i pranuar."[7]

Vlerat e besimtarëve që kryejnë haxhin, në vështrimin e Allahut janë shumë të larta. Profeti ynë i nderuar e ka shprehur këtë të vërtetë duke pohuar: "Ata që kryejnë haxhin dhe umren janë mysafirët e Allahut. Nëse i drejtohen Allahut me lutje, ai ua pranon. Në iu drejtofshin me pendesë, ai i fal."[8]

Në një tjetër hadith, që thotë: "Kryejini njërën pas tjetrës haxhin dhe umren, sepse haxhi dhe umreja i asgjësojnë varfërinë (për shkak të tregtisë që mund të bëhet) dhe gjynahet siç pastron kaceku hekurin, arin dhe argjendin prej ndryshkut"[9], na jepet sihariqi se haxhi, krahas pastrimit prej mëkateve, bëhet shkak që njeriu të shpëtojë edhe prej varfërisë.

VLERAT E HAXHIT

Haxhi dhe umreja bëhen shkak që xhamia e shenjtë e Qabesë çdo vit të mbushet me shend e gjallëri.

Haxhi e pastron egon e njeriut prej mëkateve, e bën atë të dëlirë, e pajis me kthjelltësi besimi, i çel dyert e një jete të re; përforcon jetën shpirtërore të njeriut, konsolidon besimin që ai ndien kundrejt mëshirës dhe faljes hyjnore.

Haxhi forcon e rrit besimin, ndihmon në ripërtëritjen e besës së dhënë Allahut, çon drejt asaj pendese të fuqishme që nuk shkelet lehtë, e pastron krejt shpirtin duke rafinuar ndjenjat dhe thuajse i jep krahë atij.

Haxhi i kujton njeriut të kaluarën e shkëlqyer të Islamit. Ai i sjell ndërmend besimtarit Profetin tonë (paqja qoftë mbi të), që me moralin dhe me veprat e tij ndriçoi botën, si dhe sakrificat dhe heroizmat e sahabëve të tij të zgjedhur dhe eulijave, që i pasuan ata në mënyrën më të bukur.

Për më tepër, haxhi e mëson njeriun me durim, me vetëdisiplinë dhe bëhet shkak që ai të fitojë ndërgjegjen e bindjes ndaj urdhëresave hyjnore.

Përmes ritualit të haxhit, njeriu e falënderon më mirë Zotin e vet, gjen rrugën e të qenit më thellësisht mirënjohës për mirësitë e pasurisë, të shëndetit e të mirëqenies që Zoti i ka dhuruar.

---

5. Buhari; Haxh, 4.

6. Muslim, Haxh, 437; Nesai, Menasik, 3-5.

7. Buhari, Haxh, 4, Nesai, Menasik, 4.

8. IbnI Maxhe, Menasik, 5.

9. Tirmidhi; Haxh, 2; Nesai, Menasik, 6.

Për sa u përket vlerave shoqërore, haxhi, pa marrë parasysh ndarje në baza ngjyre, gjuhe, race, kombësie, kulture, pozite shoqërore e posti politik, bashkon me një qëllim të vetëm miliona myslimanë, duke u bërë shkak për krijimin e një tabloje fort të gjallë të barazisë e të vëllazërisë. Të gjithë haxhinjtë, të pasur e të varfër, të fuqishëm e të dobët, të veshur njëlloj, duke ndjekur të njëjtat rregulla, duke iu nënshtruar të njëjtave vështirësi, duke lëvizur në të njëjtat kushte, kalojnë nëpër një edukim të barazisë fizike e të vëllazërisë.

Teksa një besimtar i pasur që ka në zotërim pasuri të mëdha, sikurse dhe një besimtar më i varfër e që përjeton shumë vështirësi ekonomike, ngrenë së bashku duart për t'u lutur në Arafat e ecin pranë e pranë në tavaf rrotull Qabesë, ibadeti i haxhit u mëson njerëzve që të mos mburren me pozitën shoqërore e politike, me begatinë e me pasurinë, por të njihen e të shoqërohen me myslimanë të tjerë.

Rituali i haxhit lë te myslimanët kujtime të thella që nuk do të fshihen gjatë gjithë jetës.

Në sajë të haxhit, mes myslimanëve që vijnë e bashkohen nga vende të ndryshme të botës lindin njohje e ndërveprime të bukura.

Myslimani që kryen haxhin zhvillon cilësi të bukura si durimi, kapërcimi i vështirësive, të mbështeturit dhe të ndihmuarit e ndërsjellë dhe përshtatja me rregulla të caktuara.

Haxhi i mbart vizitorët në kohë katërmbëdhjetë shekuj më parë. Ai i bën ata të kujtojnë Profetin e Profetëve, u kujton atyre ato beteja të mëdha që janë zhvilluar në ato vende.

Haxhi e bën njeriun të përjetojë një panoramë, që i përket parajsës dhe i shfaq të vërtetën se në këtë botë s'është veçse një mysafir.

Çdo vit, nga të katër anët e botës, miliona njerëz i drejtohen Shtëpisë së Allahut në një hapësirë të bekuar kohe dhe çojnë në vend detyrën e tyre dhe pastrohen prej mëkatesh.

Haxhi, si një simbol i Islamit, që lartëson e shpërfaq bashkimin shoqëror mes myslimanëve, është aq madhështor e gjithëpërfshirës, saqë gjerësia dhe hapësira e tij nuk është e mundur të vërehet në asnjë tjetër vend a bashkësi në faqe të dheut. Qabeja, me atë domethënie e shenjtëri të thellë, e shtrirë që në kohërat përpara Hz. Ademit (a.s.) dhe krijimit të tij.. e më pas e rishfaqur dhe e rindërtuar me Hz. Ibrahimin (a.s.) kush e di për të satën herë, e lidhur me kombin ibrahimik, si bashkëshoqëruese e lartësisë së të vërtetës profetike në zemra, është një vatër e pashoqe monoteizmi, e tillë që, prej veçantive që mbart, nuk mund të gjendet një ndërtesë e dytë që, njëjtë me të, mund t'i thuhet shtëpi e Allahut.

Çdo vit, milona njerëz, me qëllim që të çojnë në vend detyrimin e tyre të nënshtrimit ndaj Allahut, në një copëz kohe në të cilën do të jenë më pranë se kurrë Zotit të Vërtetë, në një vend kulmor, nga dritaret e ibadeteve, që do të kryejnë ngazëllehen në aromën e ndjenjave, të mendimeve dhe ripërtërijnë besën e tyre, pastrohen prej mëkateve, sjellin ndërmend dhe i kujtojnë njëri-tjetrit përgjegjësitë ndaj shoku-shokut, rishikojnë dhe përmirësojnë më tej punët e tyre shoqërore, ekonomike, administrative e politike mbi një bazë adhurimi, që shpërfaq në të gjitha anët robërimin ndaj Zotit të Vërtetë, butësinë e zemrave, gjerësinë e ndjenjave dhe vetëdijen islame. E pastaj, me një energji të re, me një zell të ri, kthehen në vendet e tyre.

Të gjithë shkojmë në haxh edhe me mendimin se shpirti dhe ndjenjat tona janë ndotur disi dhe nga një portë e ndryshme që gjer atë ditë nuk e kemi njohur, sikur të na hapej përpara një botë e re ëndërrimesh, nisemi në udhëtim dhe në rrugët nga kalojmë shohim njërën pas tjetrës të radhitura simbolet e Islamit, i ndiejmë ato dhe zbresim në thellësi të tyre.. dhe në brendi të madhështisë së maleve të larta, ballas simboleve të tilla të Islamit, që mbushin syrin dhe zemrën tonë, ende pa mbërritur e në rrugëtim e sipër nisim të ndiejmë njëra pas tjetrës puhizat e ngrohta e të thella të Qabesë dhe të shpirtit të haxhit. E më pas, teksa mbërrijmë gjer në pikën më të fundme, në ulëset e autobusit, në dhomat e tragetit, në ndenjëset e avionit, në dhomat e hotelit, në sallonet e miqve, madje edhe në çarshi e në tregje, e ndiejmë kudo praninë e atyre erërave të ngrohta. Me të tilla mjete, në të tilla rrugë edhe në qofshim fort mirë të udhëhequr, prej këtij udhëtimi shpirtëror, harmonik, përmallues, që në varësi të mjetit, mund të zgjasë me orë, me ditë, me javë, në një kurbet, në një mbërritje të mezipritur, në një bukuri të madhërishme në shpirtrat tanë të lartësuar e të kthyer në të vluar të një bote të veçantë, na duket sikur jemi përpara një porte të mistershme, që fsheh pas vetes të gjitha këto bukuri të magjishme. Ky rrugëtim i shenjtë e meditim në udhë e sipër i dhuron kurdoherë botës sonë të brendshme një ndjesi të përtejarsyeshme e

intuitë të tillë që, në një gjendje shpirtërore, që herë lartohet në ngazëllim e herë trazohet në ndjesi vetëkontrollimi e përllogaritjeje, na bën ta ndiejmë veten sikur të ishim duke ecur me kujdes e vetëpërmbatje pikërisht nëpër korridoret e ahiretit.

Qabeja, sipas atyre që e kanë të mprehtë këndin e vështrimit, zgjon një ndjesi të të ngriturit të kokës nëpër lartësi; që vështron herë në drejtimin tonë, herë në drejtim të pafundësisë; që herë gëzon e herë hidhërohet së brendshmi e në fshehtësi.

Qabeja, për nga vendndodhja, ka pamjen e një nëne në këndin më të zgjedhur të shtëpisë sonë, e ulur në krye të qoshes duke rrezatuar respekt, që ndan gëzimet me fëmijët e me nipat dhe që dhembjet e brengat e tyre i përjeton në thellësi të shpirtit të vet. Prej këndit ku ndodhet, vështron me ëndje mjedisin përreth; vende-vende lëndohet e kruspulloset prej dhembjesh, ndërsa herë-herë me gaz shpërndan përreth stërkala shiu buzëqeshjesh.

Në tavaf, gjithsecili e ndien veten si një fëmijë i dobët që, i kapur fort për dore me të ëmën, rend në siguri e me plot ngazëllim. Njeriu, ndër ata mijëra e qindra mijëra që galdojnë në mendime parajsore përqark tij, ndizet në gaz sikur të jetë duke ecur vërtet drejt Allahut dhe nuk vetëkontrollohet më. Me trupat gjysmë të zhveshur, me rrobën në supe, përjetojnë emocionin e të rendurit duke bërë kurdoherë përpara në një rrugë sa të lodhshme e të trazuar, po aq edhe shpresëdhënëse e të sigurt. Në llogarinë e botës, kjo qetësi u shkakton njerëzve përreth shtëpisë së bekuar një thellësi të magjishme e të pamundur të përshkruhet, një ëndërr e një pafuqi.

Sa herë që shpirtrat e thellë pushtohen prej magjepsjes së këtij rrotullimi përreth Qabesë, teksa vijnë përqark, kush e di se në ç'porta të fshehta kalojnë.. në ç'trokitëse të panjohura trokasin e ç'perde u çelen! Kështu, duke ecur me ndjesi krejt të reja në çdo çast përreth kësaj ndërtese të vjetër por të paplakshme, ne mahnitemi prej dritareve që u hapen ëndrrave tona, prej përmallimeve që rrjedhin në kraharorët tanë, prej dritave që dalin prej zemrave tona dhe prej të fshehtës që ngre në fluturim shpirtrat tanë. Në çdo hap që hedhim, zhvendosemi me një ndjenjë të tillë sikur do të na hapet një portë e mistershme, që do të na ftojë në brendësi, na duket sikur po shkasim drejt një ëndjeje, natyrën e së cilës nuk e njohim, dhe ndiejmë zemrën të na rrahë me emocion. Në atë çast, në vendin që ndodhemi ndiejmë se si e gjithë madhështia, thellësia, magjepsja e Qabesë, e mbledhur në shpirtrat tanë, gjallohet e gufon në gjithë qenien tonë dhe kjo na bën të drithërohemi.

Edhe në qoftë e mundur që të tilla meditime nganjëherë të shpjegohen duke u mbështetur në disa arsye objektive, shpesh përballë kujtimeve dhe mbresave që na lindin në zemër mbetemi pa fjalë, sepse edhe nëse për nga kushtet fizike dhe dekori i jashtëm Qabeja dhe mjedisi përreth saj shprehin diçka, brendia e tyre është e mbyllur, kuptimi i tyre i turbullt dhe stili i tyre i përtejbotshëm, ndaj edhe shumëkush mund të mos i kuptojë. Sidoqoftë, amatori e specialisti, i padituri e dijetari, i vogli e i madhi, gjithsecili, pa dyshim, ka shumë e shumë për të kuptuar prej saj, megjithëse shpesh nuk është në gjendje t'i shprehë ato që kupton.

Qabeja, krahas ngjasimit me një zambak uji që lulëzon më fort mes majash e malesh të frikshme që na ngjallin drithërima, është si një llambë e qelqtë misteresh, që ruan brenda vetes të fshehtën e qenies, si një kristal i lindur prej projektimit të Sidretulmuntehasë ose prej nektarit të botëve përtejqiellore. Kur njeriu rrotullohet me vetëdije rreth asaj llambe misteresh, siç ndien plot të fshehta, që rrjedhin jashtë saj e bëhen të dukshme, herë-herë këndellet duke shikuar prej këtij prizmi të kyçur kah Sidretulmuntehaja edhe botët përtejqiellore.

Pothuajse të gjithëve, sapo gjejnë strehë në rrobën e saj, duke u thelluar edhe më tutje në gjerësinë e ndjenjave e të mendimeve, që i kanë pasur që më parë në shpirtra, duke meditur për Qabenë, për qenien e vet dhe për lidhjen mes këtyre dy përbërësve në shikimin e përmalluar të Zotit të Madhëruar, duke kaluar përmes disa portash të mistershme që çelen brenda tyre, u hapen para syve botët më intime, që gjer atëherë nuk i kanë njohur. Pa dyshim që kjo ndjesi e kjo njohje, ky kuptim i thellë e ky shpirt do të shfaqet vetëm në bashkimin e një jete të përsosur islame e të një pastërtie të plotë të fesë me besimin e padyshimtë. Përndryshe, pjesa e formave abstrakte do të mbetet e lidhur brenda kornizës së formave.

Falë kësaj thellësie e pasurie në Qabe, thuajse gjithçka atje, shumë më tepër sesa në kohët e tjera, kur ngjyroset me ndjenjën e haxhit, mbulohet me tisin e një tjetër madhështie.. mbulohet, por njeriu, i pushtuar prej magjepsjes së saj, thuajse në një spirale drite, duke u rrotulluar e rrotulluar, lartësohet dhe me një forcë tërheqëse

prej brendisë së vet shkon e mbërrin tek i Adhuruari i vet. Namazi i tavafit të kryer prej shpirtit që mbërrin në këtë pikë kthehet në sexhde falënderimi, ndërsa uji i Zemzemit që ai pi është si gurrë parajse.

Tavafin përreth Qabesë, nëse do ta përqasnim me një shprehje mistike, më së shumti si një ndjenjë të bekuar, me "sejr fil'lah" si shprehje të një udhëtimi rreth një mendimi dhe me pikësynim thellimin brenda vetes sonë, vajtje-ardhjet në hapësirën mes Safasë dhe Mervës, do të ishte e përshtatshme të interpretoheshin me kuptimet "sejr ilallah", "sejr minallah", që janë shprehje të ngjitjes e të zbritjes nga krijimi tek Krijuesi, nga Krijuesi tek krijimi. Në ecejaket mes Safasë dhe Mervës, përjetohet pikërisht një meditim i tillë dhe një rrebesh ndjenje e dëshire që buron prej këtij meditimi.

Njeriu në këtë vajtje-ardhje përjeton kurdoherë kulturën, poezinë, melodinë, bashkimin dhe përmallimin e të rendurit e të të kërkuarit, të të lypurit ndihmë e përkrahje. Aty, sikur të kemi rënë pas diçkaje të rëndësishme, ndjekjet vazhdojnë paprerë. Gjersa në çastin kur ajo çka kërkohet të shfaqet, vajtje-ardhjet vijojnë pa ndalim. Çdo gjurmë e shenjë që rastiset në atë rrugë ia shumëfishon njeriut emocionin.

Dhe siç ndodh rreth Qabesë, ai edhe rend, edhe, duke u lëkundur në spiralet brenda vetes në thellimin vetjak rrotull Shtëpisë së Allahut, i duhet të shkojë e të vijë në një vijë të drejtë, me ndjesi e emocione profetike, të tendoset me zellin për të jetuar për të tjerët, për të qeshur e qarë për të tjerët. I brengosur, por i përmbajtur, i shqetësuar, por plot shpresë, nën dritat e florinjta të qiellit, në orët kaltëruese të stinës së haxhit, por edhe me përmallimin e atij që ende nuk e ka gjetur plotësisht atë çka kërkon, shkon e vjen, rend e ecën ngadalë, i ngjitet majës, zbret që andej dhe përpëlitet në gjithë pavendosmërinë e të gjendurit në udhë e sipër. Nganjëherë rendja mes Safasë dhe Mervës trazohet me thirrjet që i ngjajnë më së shumti gurgullimës së rrjedhës së një lumi, duke shprehur ndjenjat në të kënduarit e një kori.. e nganjëherë, me një gjendje shpirtërore të tillë, që nuk sheh asgjë e askënd, sikur të ishte duke ecur krejt i vetmuar, në sy me siluetën e Haxherit, pret të zbresë prej qiellit një mëshirë hyjnore që do të shuajë flakët.. dhe bashkë me zjarrin e vet që i djeg shpirtin, përvëlohet me mallin e pashuar të pritjes. Edhe nëse nganjëherë gjatë vajtje-ardhjes ndihet freskia e një flladi që mbërrin nga largësitë, në përgjithësi aty përjetohet një hidhërim i trazuar kurdoherë më këndellje, një vuajtje dashurie e mbushur më shpresë, dëshirë dhe pavendosmëri.

Në këtë vajtje-ardhje, të vërtetat trazohen me ëndrrën dhe njerëzit përreth nganjëherë me thellësinë e heshtjes e nganjëherë me të qara plot dënesë, diku sikur po shtyhen për në drejtësinë e Ditës së Gjykimit, diku sikur po rendin drejt lumenjsh parajsorë, në dyzimin mes ëndjes dhe shqetësimit, vende vende gëlltiten të përlotur, herë herë marrin frymë lirisht.. dhe vazhdojnë vajtjet e ardhjet, ngjitjet e zbritjet. Aty orët e minutat kanë aq shumë naze, saqë kërkojnë medoemos lajkatime e përkushtim të përhershëm. Përndryshe, treten e ikin sikur të mos kishin qenë kurrë.

E ndërsa ditët shkasin drejt Bajramit, vendi i tavafit, Zemzemi dhe vajtje-ardhja mes Safasë e Mervës kaltërohen me ndjenjën e një kurbeti e përmallimi.. Qabeja nis të na i mbyllë dalëngadalë perdet e dritareve që na kishte çelë.. dhe njeriu që në çdo ngjarje sheh përkohshmërinë, siç kupton se po afron koha, që i duhet të largohet prej këndej, mendon se një ditë do të ndahet edhe nga bota dhe duke u tërhequr brenda vetes, brenda botës së tij të veçantë, kruspulloset në përshpirtshmëri.

Por ende nuk ka mbaruar gjithçka. Këta njerëz, që ecin drejt Zotit të Vërtetë, ende i pret një udhëtim fort i gjatë. Minaja, me hijeshinë e pabesueshme dhe magjepsjen marramendëse, u ka dalë përpara për t'u prerë udhën.. Mali i Arafatit, ku ndihen kërcitjet e portave të qiellit, rri e i vështron.. Muzdelifeja, pa i bërë të përjetojnë një mbrëmje të vogël dasme, duket se s'ka ndërmend t'i lëshojë.. pak më tutje do të vijnë vendet ku do të mbushen me frymëmarrjen e thellë të nënshtrimit e do të godasin me gurë mendësitë e të dhënit pas kësaj bote dhe pasi t'i paraqesin Allahut dëmshpërblimin e egos së tyre, do të përjetojnë në botën e ndjenjave festën e çlirimit të tyre; e më pas, në Qabe, duke iu drejtuar qabesë së zemrës së tyre, nga Zoti sërish për te Zoti, duke u dhënë fund ngjitjeve e zbritjeve të tyre, me frymëzimin e kujtimeve të mbetura nga "fenâ fil'lâh" dhe "beka bil'lâh", do të zbresin shi buzëqeshjesh mbi fatet e veta.

Minaja është vërtet si një koshere nënshtrimi e si një çerdhe përkushtimi të pakushtëzuar. Në gjendjen e shkuar plotësisht dhe në gjendjen e tashme pjesërisht, thuajse për të gjithë ata njerëz që, pa shtëpi e pa katandi,

pa tokë e pa dhè, pa shtet e pa çerdhe, kalojnë ndonjë ditë në Mina, ky vend është aq i mistershëm, saqë çdo shpirt që nuk është krejtësisht i mbyllur ndaj botës së amshuar ç'nuk ndien në atë vendpushim mes atyre maleve e luginave..! Minaja, me të gjitha anët e saj, na duket aq e përzier dhe e njësuar në shpirtin tonë, saqë na bëhet sikur e ndiejmë se si ajo rreh në zemrën tonë, rrjedh në venat tona, gjallon në damarët tanë. Kështu, na ndodh që sapo hedhim hapin e fusim këmbën në të, ndiejmë se si ajo ngryket me shpirtin tonë – mund të ndalemi në faktin se ajo është vendi i parë që hapi krahët për të Dërguarin e Allahut – na tregon udhët që na hapen më tutje dhe na plotëson, madje vjen e trazohet me botën tonë të ndjenjave.

Ndërsa ne bëjmë përgatitjet tona në Mina, duke i dhënë krahë shpirtit tonë, mali i Arafatit nga njëri krye në tjetrin stoliset si dhomë nuseje dhe mysafirëve që do të vijnë për t'u vendosur aty e më tej u hap kraharorin porsi një liman, si një shesh e si një tatëpjetë.. dhe mysafirët e Zotit, që rendin drejt tij me pasionin e mallit për dhenë e dashur, vihen në pritje.. mysafirë të Zotit me dëshirën për një mundësi e fillim të ri, për një epokë të re.

Arafati ka një përndritje të tillë dhe koha që kalohet atje ka një thellësi të tillë, saqë një shpirt që e ka arritur një herë fatbardhësinë e të gjendurit në atë kopsht, asnjëherë nuk i rrënohet krejtësisht qëndrueshmëria dhe kurrsesi nuk vdes në gjendjen e atyre, që jetojnë të dhënë krejtësisht pas kësaj bote. Ata që kanë kaluar pak orë të jetës së tyre në Arafat, gjithë jetën hapen si trëndafilat dhe kurrë nuk thahen. Minutat e tij të dhembshura, plot dashuri, gjithmonë rrezatojnë në sytë tanë si dielli i mëngjesit.. dhe thirrjet e gjithë atyre njerëzve, që pranë tij janë të prekur e të përlotur prej dashurisë, që lartojnë cicërima si bilbili, që së kënduari zemra u rreh fort prej besimit, prej përkushtimit, prej dashurisë e prej joshjes, që cicërojnë e galdojnë shpirtrat tanë të përmalluar, aq sa cekin ëndjet më të pabesueshme, më të paarritshme.. lartësojnë ndjenjat tona me përkujtimet më të pjekura e më të përsosura.

Në Arafat, agimet dhe perëndimet kurdoherë fryjnë një puhizë thellësie dhe në zemrat tona zbrazin fjalë të hijshme, që me shumë gjasa as poetët më të mëdhenj nuk do të mund t'i këndonin, e ç'nuk na pështpërisin për hir të qëllimeve të ekzistencës sonë. Në mënyrë që shpirti t'i amshohet, njeriu së paku njëherë duhet të prekë Arafatin, të jetojë Arafatin dhe si oksigjen të frymëmarrë në mushkëritë e veta agun dhe perëndimin e Arafatit.

Në Arafat, njeriu bëhet dëshmitar i lutjes, i përgjërimit, i tërheqjes së brendshme dhe i shprehjes së jashtme më drithëruese të mundshme. Veçanërisht drejt fundit të pasdites, lutjet e kryera në një atmosferë të ngarkuar me ndjesinë e lamtumirës vishen, marrin zë e marrin frymë më thellësisht dhe mbërrijnë një gjerësi e një lartësi prej përtej qiejsh, që sjellin ndërmend thirrje engjëllore. Njeriu, kur dëgjon ngashërimat e vajit, që ngrihen në lartësinë e Arafatit, i duket sikur amshimi në zëra, butësia që lind prej shpresës së lumturisë së përjetshme, rigjallërohen e përjetësohen plot dhembshuri e dëshirë dhe pësojnë një çelje e zgjerim madhështor. Veçanërisht pasi dielli ka perënduar dhe në horizontet e errësuara muzgu bën të na lindin ndjenja lamtumire, na duket sikur vetëdija jonë ndriçohet me përkujtimin e Arafatit dhe pikërisht si në botën e ëndrrave, sikur u ikim modeleve dhe na çelen përballë disa paqartësi shpirtërore.. sikur vajtojmë si vetë Arafati në ngashërime.. sikur shkrihemi e ikim bashkë me diellin që perëndon.. sikur lehtësohemi dhe, si zogjtë, në njëfarë mënyre marrim krahë.. dhe sikur, duke ndryshuar thelbin tonë, kthehemi në një qenie shpirtërore dhe, krejt të habitur, mbetemi të palëvizur në vend.

Arafati është një rrëpirë mëshire e një shesh mahsheri i mbushur me shqetësimin e llogaridhënies, në të cilin njerëzit një ditë të tërë shëtisin mes turmash engjëjsh, ku në çdo ulje e ngritje ata frymëmarrin vazhdimisht qielloren, ku mëshira e Allahut zbrazet plot bujari në shpirtrat tanë dhe ku ngjarjet rrjedhin kurdoherë në shpresa shumëngjyrëshe. Të zhveshur e të larguar prej gjithçkaje të kësaj bote, me shqetësimin e peshores e të llogarisë dhe me shpresën e mëshirës, njerëzit enden si mirazhe në rrafshësitë e tij. Ata shpresojnë të gëzojnë falje, jetojnë ëndrrat e arritjes së shpëtimit dhe këtë ditë të vetme e vlerësojnë sikur të duan të nxjerrin prej saj fitimin e viteve të tëra.. e vlerësojnë, por nuk u hiqet nga mendja se sërish do të duhet të luten e të shkojnë në një tjetër vend.

E nuk ka nevojë të mundohen shumë për të mos e hequr nga mendja, sepse vetëm pak hapa më tutje ata i pret me kraharorin hapur Muzdelifeja. Sapo marrim mesazhin se Muzdelifeja po na pret, ndahemi prej dritave e prej Arafatit që na dhuron buzëqeshje shpresëplota dhe ecim drejt Muzdelifesë, që mbart namin e të qenit më afër Allahut në nivelin që sexhdja është kundrejt rukusë.. siç ecim drejt të pafundmes, drejt të pavendshmes,

drejt përjetësisë dhe drejt Allahut, ecim drejt Muzdelifesë. Drita e hënës që ka nisur të bëhet e plotë, zë e ndriçon çdo mal e rrjedhë, çdo luginë e çdo tatëpjetë, çdo anë e kënd në një vend që vezullon prej dritëzash e në të cilin qiejt zbresin në tokë dhe toka trazohet në ndjenja qiellore, e gjejmë veten si në një liman, në një skelë e në një mol të veçantë, që na çon te Zoti i Vërtetë. Me gjendjen e pandryshueshme shpirtërore që prej Qabesë, duke parë e ndier fytyrën e kthjellët dhe të çelët të qiellit të pasqyruar në mimikën e haxhinjve, në jehonën e zërave të këtyre shërbëtorëve besnikë, që i drejtohen me lutje Zotit të tyre, në trupat tanë, në shpirtrat tanë, në sytë e në zemrat tona rendim përtej dhe përtejësohemi, njëjtësohemi në substancë e në përmasë me engjëjt e me botën engjëllore dhe e çlirojmë veten në krejt gjerësitë e mëshirës hyjnore.

Ibn Abasi thotë se Profeti i dashur, arriti në Muzdelife, për umetin e vet, të merrte një recetë ndihme e çlirimi që nuk e mori dot në Arafat. Në qoftë siç thotë Ibn Abasi fisnik, Muzdelifeja, që i afron njerëzit tek Allahu gjer në masën e mbërritjes së kokës në sexhde, kërkon një tjetër ngashërim..

Thuajse nga çdo anë e Muzdelifesë, bashkë me dritat që vezullojnë prej llambave, fytyrat e ndritshme të haxhinjve, shikimet e tyre të përqara dhe zemrat që u rrahin fort prej emocionesh, i dhurojnë asaj fushe të bekuar, që e njohim veç prej netëve, një bukuri të veçantë e magjepsëse. Ndërsa disa çlodhen për detyrat e vështira që i presin ditën e nesërme, ka njerëz që gjer në mëngjes mbeten të ulur me duar të hapura. Këta shpirtra të gjerë e tërheqin zërin e tyre në zemër dhe kushedi se ç'mendojnë, ç'këndojnë e ç'u shkon ndër mend teksa, porsi një pendëz, prej kraharorit nxjerrin melodi veç për të Zotin e kraharorëve..! Zërat e zemrës kurdoherë rrjedhin në një nivel që i kapërcen ata vetë dhe lartësohen në frymëmarrjen e engjëjve. Njerëzit e kësaj kohe mbi kohën, që dëgjojnë me zemër e flasin po me zemër, krahas këtyre melodive të shpirtit, që luajnë tani e që kanë luajtur më parë, madje edhe shumë më parë, me pendën e ndjenjave e mbi telat e shpirtit, mundohen që sado tinguj që të ketë, t'i ndiejnë të gjithë së bashku porsi një kor dhe të kaluarën bashkë me të sotmen, porsi një ëndje prej burimi Zemzemi, t'i pinë gllënjkë pas gllënjke.

Kur në horizonte nisin të zbardhin shenjat e agimit, e gjithë ajo frymëmarrje zëri, ato ndjenja dhe emocione që një ditë më parë përjetoheshin në Arafat, tani rrjedhin të shtuara e të shumëfishuara në Muzdelife.. rrjedhin dhe vendi zbardh i trazuar me plot e plot ndjenja, me plot e plot ngashërime. Lutje drejtuar Zotit jashtë namazit, dashuri e përkushtim shprehur brenda namazit.. dhe çdo lutje që rrjedh e gjen shprehje të heshtur brenda namazit, si një përmasë e veçantë e afrisë ndaj Zotit, kryhet me një thellësi përmbi thelbin e brendinë.

Këto lutje e përgjërime vazhdojnë gjersa rrezet e diellit të shfaqen në horizont me sihariqin e mbërritjes së një dite të re. Ndërsa dielli lind, kokat që thuajse gjer në atë çast kanë qenë në sexhde, për të mbërritur një tjetër afri, bëhen sërish gati të "tërheqin frerët" dhe vihen në udhë. Tani vjen sërish Minaja, në të cilën ishim edhe më parë dhe që e kaluam duke na përshëndetur me selame luginë pas lugine. Minaja, në të cilën zemrat që kanë arritur dëlirësinë, duke u çliruar prej të arsyetuarit të rrafshët, do të dorëzojnë shpirtin e tyre.. Minaja, vendi ku qysh prej Ademit e deri tek Ibrahimi, njerëz në mijëra porsi yjet në qiell, në qindramijëra duke ndalur mendjen dhe arsyetimin, krijojnë lidhjen me zemrën.. së fundi, pas të gjitha këtyre, teksa edhe shpirtrat tanë marrin atë çka u takon, duke goditur me gurë shejtanin, Minaja, në të cilën nënshtrimi si thelbi i adhurimit përfaqësohet prej shpirtit të mahsherit.. Dhe krahas goditjes me gurë të shejtanit, e ç'nuk bëhet tjetër atje.. kurbani, qethja, zhveshja prej ihramit.. dhe pas përqendrimit që thellohet gjithnjë e më shumë gjatë rrugës, tavafi i detyrueshëm që kryhet me një tendosje të plotë metafizike, përbëjnë vetëm diçka prej gjithçkasë..

Udhëtari i haxhit, që nga çasti që largohet nga shtëpia, gjatë rrugës, çlirohet hap pas hapi e fije për fije prej egos dhe prej unit; në drejtim të jetës së zemrës e të shpirtit, thuajse si një dantellë, thuret fije për fije me mëndafsh. Po, njeriu në këtë udhëtim prej drite të tij njihet e bëhet pjesë e të vërtetave të vjetra, por që nuk vjetrohen, të përjetshme e pa fillim, por që mbeten kurdoherë të freskëta.. dhe mbërrin në përmbushje që s'do t'i harrojë kurrë. Sidomos për ata që janë në vetëdijen e veprës që kryejnë, ky udhëtim në dukje tokësor, por në fakt qiellor, me kujtimet e ndjesitë që mbart, thellohet edhe më tej gjersa nis të shtrihet në pafundësi.. fillon dhe duket sikur ngjyrat e qiellit, zërat e haxhinjve vijnë rrotull në ëndrrat tona, pushtojnë shpirtin tonë dhe shpërfaqen për gjithë jetën në sytë e shpirtit tonë.

Edhe në qoftë disi e trishtë, Qabeja dhe rrethinat e saj përbëjnë një vend plot magjepsje e joshje, që nuk gjendet kurrkund tjetër në botë. Njeriu, pranë pëlhurës së saj, kurdoherë është dëshmitar i një kohe përrallore. Gjithçka prej saj e rrëmben dhe ai ushqehet prej saj si të kishte këputur frutën më të pjekur e më të ëmbël. Shpirtrat që kanë fatin e përbashkët të këndellin sytë në atë vend, çlirohen në përjetësi prej mundimit të të kërkuarit të një tjetër vendi adhurimi.. dhe forcën tërheqëse me përmasa të përtejbotshme të atij vendi nuk e harrojnë kurrë, gjer në perëndim të jetës së tyre.[10]

PJESA E DYTË

KUSHTET E HAXHIT

Kushtet e haxhit ndahen në tri grupe:
Kushtet e detyrimit të haxhit
Kushtet e përmbushjes së haxhit
Kushtet e saktësisë së haxhit.

KUSHTET E DETYRIMIT TË HAXHIT

Që ibadeti i haxhit të jetë farz për një individ, së pari ky duhet të jetë mysliman, me aftësi normale mendore e të ketë mbërritur moshën e pjekurisë, të jetë i lirë; të ketë mundësi të mjaftueshme fizike e financiare për të bërë haxhin. Kjo mundësi apo realizueshmëri, në librat e fikhut shprehet me termin "istitaat".

Që dikush të jetë i ngarkuar me detyrimin e ibadetit të haxhit, krahas atyre që u përmendën më sipër, kërkohet të jetë mbërritur edhe koha e duhur për ta çuar në vend këtë detyrim. Nëse dikush, pavarësisht nga përmbushja e të gjitha kushteve të sipërpërmendura, vdes pa e mbërritur dot stinën e haxhit, konsiderohet të jetë ndarë nga jeta pa qenë i ngarkuar me përgjegjësinë e të shkuarit në haxh.

Ibadeti i haxhit kryhet në muajt e haxhit. Muajt e haxhit, mbështetur në kalendarin hënor, janë shevali, dhilkadeja dhe dhjetë ditët e para të dhilhixhesë. Jashtë kësaj periudhe, nuk mund të hyhet në ihram për detyrimin e haxhit dhe nuk mund të zbatohen ruknet e haxhit.

Mundësia dhe aftësia për të kryer haxhin ka kuptimin që individi që do të shkojë në haxh të jetë në gjendje të mjaftueshme financiare për të siguruar jetesën e njerëzve e të familjarëve që ka në ngarkim sipas nivelit shoqëror që u përshtatet, që nga largimi e gjer në kthim.

Brenda konceptit të mundësisë, ka nga ata që kanë përmendur edhe sigurinë fizike, sigurinë e pronës dhe atë të udhëtimit. Dijetarët e medhhebit hanefi, duke iu referuar shprehjes së përmendur në ajetin e shenjtë të Kur'anit, **"ata që mund të gjejnë rrugë e u mjafton fuqia për të shkuar në haxh..."**, kanë pohuar se ajo përfshin elementet e "mundësisë fizike, financiare dhe të sigurisë së rrugës."

10. Muhammed Fethullah Gülen, "Yeşeren Düşünceler", f. 61.

Nëse njëri nga kushtet që e bën të detyrueshëm haxhin nuk përmbushet, atëherë haxhi nuk është farz dhe nuk përbën një detyrim për t'u zbatuar.

KUSHTET E PËRMBUSHJES SË HAXHIT

Kushtet që dikush që e ka të detyruar haxhin ta përmbushë personalisht këtë detyrim quhen "kushtet e përmbushjes së haxhit". Këto kushte, në vija të përgjithshme, janë si më poshtë:

a. Të jesh i shëndetshëm

Individi i ngarkuar me detyrimin e kryerjes së haxhit duhet të gëzojë një shëndet që t'ia lejojë këtë vetes. Në të kundërt, nëse dikush që e ka të detyruar haxhin përballet me një sëmundje apo gjymtim, që i bëhet pengesë për këtë, duhet të dërgojë dikë tjetër në vend të vet ose ta lërë këtë porosi në testament.

Sëmundjet dhe gjymtimet, që mund të pengojnë kryerjen e haxhit, në mënyrë të përgjithshme, janë: verbimi, paraliza e këmbëve, paraliza e plotë, humbja e të dyja këmbëve, sëmundja që e bën të papërballuesshme udhëtimin e haxhit ose mosha shumë e thyer.

b. Siguria e udhëtimit

Garantimi i sigurisë së rrugës.

c. Ekzistenca e një pengese aksidentale

Nëse në stinën e haxhit rastis ndonjë gjendje arresti apo ndalim udhëtimi jashtë vendit, detyrimi i haxhit nuk çohet në vend.

Gjendje të veçanta të grave

Në rastin e grave ekziston kushti i shoqërimit nga bashkëshorti, apo nga ndonjë i afërm, çka nuk ka të bëjë drejtpërdrejt me përmbushjen e detyrimit të haxhit, por me ndalimin për të udhëtuar vetëm në largësi të mëdha. Sipas këndvështrimit të përgjithshëm, në largësi më të mëdha se 90 km, në rastin e të cilave zbatohen hukmet e udhëtimit, nuk është gjykuar e lejuar që gratë të udhëtojnë vetëm.

Mirëpo sipas disa vlerësimeve të tjera (sipas shafive), është parë si thelbësore parrezikshmëria e rrugës dhe siguria e grave dhe nuk është vënë kushti i udhëtimit në shoqërimin e bashkëshortit, apo të ndonjë të afërmi, nëse së paku tri gra udhëtojnë së bashku. Madje nëse gruaja ndihet e sigurt, është lejuar edhe udhëtimi i saj vetëm.

Nëse dikush nuk përmbush ndonjërin prej kushteve të sipërpërmendura të haxhit dhe nuk mund të udhëtojë vetë për në haxh, atëherë duhet të dërgojë dikë tjetër si përfaqësues (bedel) ose duhet ta lërë këtë si porosi në testament.

KUSHTET E SAKTËSISË SË HAXHIT

Në mënyrë që haxhi i kryer të jetë i vlefshëm, është e nevojshme përmbushja e tri kushteve:
Hyrja në ihram me nijetin e kryerjes së haxhit.
Koha specifike (e caktuar).
Vendi specifik.

IHRAMI

Në kuptimin e fjalorit, krahas kuptimit "të ndalosh, t'i ndalosh vetes diçka", fjala "ihram" do të thotë edhe "të hysh në kohën e nevojshme dhe në vendin e nevojshëm, duke treguar respektin përkatës".

Si term, ihrami ka kuptimin që "dikush që ka bërë nijetin për të kryer haxh apo umre, gjer në përmbushjen e shtyllave të haxhit apo të umres, t'i ndalojë vetes disa veprime e sjellje që gjatë kohëve të tjera të vitit janë të lejuara."

Shkelja e këtyre ndalimeve, që kanë të bëjnë me veshjen, me jetën seksuale dhe me gjuetinë, sipas llojit të ndalimit dhe formës së shkeljes, kërkon marrjen përsipër të formave të caktuara të shlyerjeve. Këto shlyerje përbëhen prej therjes së kurbanit, dhënies së sadakasë dhe agjërimit.

Ihram quhet edhe veshja e veçantë, e përbërë prej peshqirit mbulues, apo prej rrobash të ngjashme të paqepura, që është gjithashtu kusht për hyrjen në ihram sipas kuptimit të përmendur më sipër.

RUKNET E IHRAMIT

Sipas hanefive, ihrami ka dy rukne: nijetin dhe telbijen. Nëse dikush braktis njërin prej këtyre rukneve, nuk konsiderohet të ketë hyrë në ihram.

Nijeti është marrja e vendimit për kryerjen e llojit përkatës të haxhit apo të umres. Vendi i nijetit është zemra. Me kushtin që zemra të mos jetë e pakujdesshme, shprehja e nijetit me gojë është, gjithashtu, mustehab. Nëse haxhi që do të kryhet, në bazë të formës, është haxh i llojit "temettu", nijeti bëhet në këtë mënyrë: "O Zoti im, për hir tënd dua të bëj umre. Ma lehtëso dhe ma prano!" Duke thënë këtë, është realizuar hyrja në ihram.

Telbija recitohet lutja e mëposhtme:

"Lebbejke allahumme lebbejk. Lebbejke la sherike leke lebbejk. Innel hamde uen ni'mete leke uel mulke la sherike lek."

"O Zoti im! Ju përgjigja urdhrit Tënd, respektova ftesën Tënde dhe erdha, Allahu im. Mjaft që Ti të urdhërosh. Duke iu bindur urdhrit Tënd, t'u drejtova Ty, o Zoti im. Ti nuk ke shok. Pa dyshim, lavdia të përket Ty, begatia të përket Ty, pasuria të përket Ty. Ti nuk ke të barabartë."

Thënia e telbijes një herë duke hyrë në ihram është farz, ndërsa përsëritja e saj herë herë me zë është sunet. Gratë qoftë në rastin e telbijes, qoftë në duatë, dhikret dhe tesbihët e tjera nuk e ngrenë shumë zërin.

KOHA E HYRJES NË IHRAM

Pa hyrë muajt e haxhit, nuk bëhet asgjë prej Menasikut të haxhit. Sipas hanefive, hyrja në ihram pa nisur ende muajt e haxhit, krahas të qenit mekruh, nuk është e ndaluar, sepse ihrami nuk është pjesë e rukneve të haxhit, por pjesë e saktësisë së kryerjes së haxhit. Ndryshe nga ibadetet e tjera, për përmbushjen e kushtit nuk është e nevojshme hyrja e kohës së caktuar.

Përsa i përket umres, duke qenë se kjo nuk ka një kohë të caktuar për t'u kryer, për të mund të hyhet në ihram në çdo kohë.

VENDET E HYRJES NË IHRAM (MIKATET)

Me "mikat" kuptohet vendi dhe koha e hyrjes në ihram, ndërsa si term, ai shpreh vendet e veçanta në zonat e ndryshme në mjedisin e Mekës, në të cilat të ardhurit për haxh hyjnë në ihram. Në Kur'anin fisnik, Qabeja është cilësuar "Bejtul Haram" (Maide, 5/2), xhamia në mjedisin e saj "Mesxhidul Haram" (Isra 17/1), qyteti i Mekës, në të cilin ndodhen kjo xhami dhe Qabeja është quajtur "Harem" (Kasas, 28/57; Ankebut, 29/67) dhe në tërësi, Qabeja dhe mjedisi i vendeve aty pranë që e rrethojnë atë dhe zonën përreth janë vlerësuar si "të denja për respekt". Vendet përreth mjedisit të Qabesë janë ndarë në tri zona, të njohura si "Harem", "Hil" dhe

"Afak". Gjendja e atyre që do të bëjnë nijet për të kryer haxhin dhe umren paraqet ndryshim sipas këtyre zonave.

ZONA E HAREMIT

Meka dhe mjedisi i saj është një zonë në të cilën mbizotërojnë siguria dhe paprekshmëria, në të cilën, në kufijtë e treguar prej Xhibrilit (a.s.) e të caktuar prej Ibrahimit, më pas të ripërtërirë prej Profetit tonë të nderuar, nuk mund të priten pemët, nuk mund të dëmtohet gjelbërimi, nuk mund të cenohen kafshët e gjahut dhe nuk mund të preken gjallesat.

Popullsia banuese në Mekë hyn në ihram për haxh brenda kufijve të Haremit dhe për umre jashtë këtyre kufijve, që do të thotë duke dalë në Tenim, që është më pranë zonës së Hilit, ose në Arafat.

ZONA E HILIT

Kjo është hapësira mes zonave të Haremit e të Mikatit. Ata që jetojnë në këtë zonë, hyjnë në ihram në vendin ku ndodhen, nga jashtë zonës së Haremit.

ZONA E AFAKUT

Vendeve jashtë zonave të Haremit e të Hilit u thuhet Afak. Profeti ynë (paqja qoftë mbi të) ka përmendur pesë pika, të cilat nuk duhet të kalohen pa ihram prej atyre, që vijnë nga zona e Afakut në zonën e Mekës ose të Haremit. Ata që qëndrojnë në zonën e Afakut quhen "afaki".

Pesë pikat që nuk duhen kaluar pa ihram prej atyre që vijnë në zonën e Mekës ose të Haremit janë këto:

Dhulhulejfe: është mikati i të ardhurve në Mekë ose në Harem nga drejtimi i Medinës, në largësi afro 10 km nga Medina dhe 450 km nga Meka. Ky është mikati më i largët nga Meka. Profeti ynë, kur bëri nijet për kryerjen e haxhit të lamtumirës, hyri në ihram në këtë mikat.

Xhuhfe (Rabig): Është mikati i të ardhurve nga drejtimi i Egjiptit dhe i Sirisë. Largësia e tij nga Meka është afro 187 km.

Dhatuirk: Është mikati i të ardhurve nga drejtimi i Irakut. Largësia e tij nga Meka është afro 94 km.

Jelemlem: Është mikati i të ardhurve nga drejtimi i Jemenit dhe i Indisë. Largësia e tij nga Meka është 54 km, çka e bën atë mikatin më të afërt me Mekën.

Karnu'l-Menazil: Është mikati i të ardhurve nga drejtimi i Nexhdit dhe i Kuvajtit. Largësia e tij nga Meka është 96 km.

Ndërsa për të ardhurit në rrugë ajrore, është e nevojshme që të hyjnë në ihram pa e kaluar vijën e mikatit përkatës për drejtimin nga i cili vijnë. Sidoqoftë, duke qenë se hyrja në ihram në avion mund të jetë e vështirë, hyrja në ihram që në aeroport mund të jetë një praktikë më e mirë.

Hyrja pa ihram në zonën e Haremit

Me çfarëdo synimi qoftë, afakinjtë që do të vijnë nga larg drejt e në zonën e Haremit, për shembull afakinjtë që do të shkojnë në Mekë, duhet të hyjnë në ihram pa e kaluar kufirin e mikatit. Afaki quhet ai që vjen në Mekë nga jashtë kufijve të mikatit. Ihrami, për të respektuar këtë zonë të shenjtë, është bërë i detyrueshëm (vaxhib). Për këtë çështje, mes atyre që shkojnë për haxh e umre dhe të tjerëve që shkojnë për tregti, për vizitë apo për arsye shëndetësore, nuk ka ndonjë dallim. Këta, pasi kryejnë haxh dhe umre, dalin nga ihrami. I njëjti hukëm vlen edhe për njerëzit që, për çfarëdolloj arsyeje, ndodhen në zonat e Hilit e të Haremit jashtë kufijve të mikatit.

Popullsia e zonës së Hilit, kur nuk do të kryejnë haxh ose umre, mund të hyjnë e të dalin nga zona e Hilit pa ihram. Ata që gjenden në zonën e Haremit, qofshin mekas, qofshin të ardhur nga larg, kur shkojnë në zonën e Hilit, si p.sh. në Xhidde, mund të kthehen në zonën e Haremit pa ihram.

Afakinjtë që, pa pasur kanë synimin e drejtpërdrejtë për të shkuar në zonën e Haremit, do të shkojnë në cilindo vend të zonës së Hilit, si për shembull në Xhidde, nuk është e nevojshme që ta kalojnë kufirin e mikatit me ihram. Nëse këta më pas dëshirojnë të shkojnë në zonën e Haremit, për shembull në Mekë, i nënshtrohen hukmit të atyre që banojnë në zonën e Hilit. Nëse nuk është synimi për haxh ose për umre, mund të hyjnë në zonën e Haremit pa ihram dhe nëse dëshirojnë, mund të bëjnë edhe tavaf në Qabe.

Ata që e kalojnë kufirin pa ihram për të bërë vizitë në Medine përpara haxhit, nëse janë të detyruar që, pasi të zbresin në Xhide, të shkojnë së pari në Mekë, hyjnë në ihram në Xhidde, pa e kaluar kufirin e zonës së Haremit.

VAXHIBET E IHRAMIT

*** Të mos kalohen pa ihram kufijtë e mikatit.**

Afakinjtë që banojnë jashtë kufijve të mikatit, nëse e kalojnë kufirin e mikatit pa ihram, duhet që, si shlyerje, të bëjnë kurban një dele ose një dhi. Krahas kësaj, nëse dikush kalon mikatin pa ihram ende pa filluar ndonjërin prej veprimeve të haxhit apo të umres, si për shembull tavafin e kudumit ose tavafin e umres, mund të kthehet në mikat e të hyjnë në ihram dhe kështu bie detyrimi i shlyerjes me kurban. Madje ai, në vend të mikatit, kufirin e të cilit e kaloi pa ihram, mund të zgjedhë të shkojë në mikatin më të afërt dhe të hyjë atje në ihram. Nëse pas kalimit të mikatit është filluar ndonjëri prej Menasikëve të haxhit ose të umres, atëherë edhe nëse kthehet në mikat, detyrimi i shlyerjes me kurban nuk bie.

*** Të respektohen ndalimet e ihramit.**

Nga sjelljet dhe veprimet që nuk përputhen me shpirtin dhe me brendinë e haxhit duhet qëndruar larg. Këto do të shpjegohen më tutje si ndalime të ihramit.

SUNETET E IHRAMIT

Përpara hyrjes në ihram, përpara nijetit dhe telbijes; krahas pastërtisë së përgjithshme të tregohet kujdes që të priten thonjtë, të pastrohen qimet prej organeve gjenitale e prej sqetullave, nëse është e nevojshme të priten flokët, të merret gusul, nëse nuk merret dot gusul të merret abdest, meshkujt të mbështjellin trupin me dy copat e paqepura të peshqirit, të quajtura izar dhe rida, që varen nga mesi e poshtë dhe që mbulojnë pjesën e sipërme të trupit, pas mbështjelljes me veshjet e ihramit, nëse nuk është kohë keraheti, të falen dy rekate namaz, duke kënduar në rekatin e parë, pas sures "Fatiha", suren "Kafirun", dhe në rekatin e dytë suren "Ihlas", të bëhet telbije sa herë që të jetë mundësia gjatë gjithë kohës së qëndrimit në ihram. Për haxhin, të hyhet në ihram pasi të fillojnë muajt e haxhit.

NDALIMET E IHRAMIT

Ndalimet e ihramit, sipas fushave të ndryshme, mund të grupohen në këtë mënyrë:

NDALIMET TRUPORE TË PERSONIT ME IHRAM

* Qethja e flokëve, rruajtja e mjekrës dhe prerja e mustaqeve.

* Rruajtja, shkurtimi ose shkulja e qimeve në çfarëdo vend të trupit. Të prerit e thonjve.

* Ngjyrosja e mjekrës dhe e mustaqeve me qëllim stolisjeje, vajosja, përdorimi i llakut në flokë, përdorimi i parfumeve në trup, përdorimi i makijazhit dhe i të kuqit të buzëve prej grave, përdorimi i sapunit me aromë dhe të tjera si këto.

NDALIME NË LIDHJE ME RROBËN

DHE VESHJEN

* Veshja e rrobave të zakonshme (të qepura ose të thurura), mbulimi i kokës dhe i fytyrës, mbulimi i kokës me takije apo me objekte të ngjashme, vënia e çallmës në kokë, përdorimi i dorezave, i çorapeve dhe i këpucëve që mbulojnë thembrat janë të ndaluara.

* Hedhja krahëve e veshjeve si palltot dhe pardesytë, pa i veshur ato, nuk është e ndaluar. Në rripin që vihet në bel, në çantën që varet në krah, në atë çka vishet mbi këmbë dhe në këpucët që nuk mbulojnë thembrat lejohet të ketë qepje.

Ndalimet për veshjen e rrobave janë vetëm për meshkujt. Grave u lejohet që të mbajnë veshjet e zakonshme, ndërsa nuk mund t'i mbulojnë fytyrat gjatë ihramit.

NDALIME NË LIDHJE ME ÇËSHTJET INTIME

* Marrëdhëniet intime dhe sjellje që përgjithësisht çojnë në marrëdhënie seksuale, si puthjet, fërkimet dhe prekjet seksuale janë të ndaluara. Madje edhe përdorimi i fjalëve që nxisin ndjesi sensualiteti është po kështu i ndaluar.

NDALIME NË LIDHJE ME ZONËN E HAREMIT

* Në Mekë dhe në zonën e Haremit është e ndaluar për të gjithë gjuetia e kafshëve të gjahut, prerja apo këputja e bimëve, qoftë në ihram, qoftë jashtë ihramit.

NDALIMET QË BIEN NDESH ME TË DREJTAT E TË TJERËVE

*** Fusuk:** Të kryerit e veprimeve që konsiderohen si rebelim, e që çojnë në largim nga respektimi i urdhëresave dhe i ndalimeve të caktuara prej Allahut.

*** Xhidal:** Lëndimi i zemrave përmes debatesh, grindjesh, fyerjesh e fjalëve **të rënda, prishja e paqes. Duhet bërë kujdes që, veçanërisht gjatë kohës së të qenit në ihram, të shmangen sjellje të tilla që cenojnë sigurinë dhe paqen shoqërore.**

* Qoftë në zonën e Haremit, qoftë jashtë saj, është e ndaluar që të ushtrohet gjueti e çdo kafshe gjahu, pavarësisht nëse është i konsumueshëm apo jo mishi i saj. Po ashtu, është e ndaluar që të ndihmohet gjuetari, t'i tregohet atij se ku ndodhet gjahu, apo t'u shkaktohet dëm kafshëve të tilla.

SJELLJE DHE VEPRIME QË NUK JANË TË NDALUARA NË IHRAM

* Të qëndrohet nën hije, të përdoret çadër
* Të ndërrohen mbulesat e ihramit
* Të bëhet banjë, të përdoret sapun pa aromë
* Të lahen dhëmbët, të përdoret pomadë
* Të hiqet dhëmb, të jepet gjak, të merret injeksion, të vihet garzë mbi ndonjë plagë të mundshme
* Të hiqet thoi i thyer apo ndonjë qime që sjell shqetësim
* Të mbahet armë, byzylyk, unazë dhe orë dore
* Të lidhet rrip, të mbahet çantë në krah
* T'u merret aromë luleve ose frutave

* Të hyhet në dyqane ku shiten parfume dhe të blihen prej tyre
* Të mbështjellit me mbulesa si jorgan apo batanije pa e mbuluar fytyrën dhe kokën
* Të hidhen krahëve rroba të qepura si pallto a xhaketë pa i futur krahët në mëngët e tyre.

KOHA E VEÇANTË

Farzet e haxhit, pra hyrja në ihram, ndalimi në Arafat (vakfe) dhe tavafi i vizitës duhen kryer në kohën e caktuar për to dhe kjo bën pjesë në kushtet e saktësisë apo të vlefshmërisë së haxhit.

Adhurimi i haxhit mund të kryhet gjatë gjithë muajve e shevalit, të dhilkadesë, si dhe në dhjetë ditët e para të dhilhixhes. Përpara këtyre muajve Menasiku i haxhit nuk niset. Secili prej Menasikëve të haxhit (vakfe, tavafi, sa'ji, goditja me gurë e shejtanit) duhet kryer në kohët e caktuara brenda këtyre muajve. Në të kundërt, ato nuk konsiderohen të vlefshme.

VENDI I VEÇANTË

Farzet e haxhit duhen kryer në vendet e caktuara. Kjo do të thotë që ndalimi në Arafat (vakfe) të kryhet brenda kufijve të Arafatit dhe tavafi rreth Qabesë brenda kufijve të mesxhidit.

RUKNET E HAXHIT

Sipas hanefive, haxhi ka tri farze, që janë **ihrami, vakfeja e Arafatit** dhe **tavafi i vizitës**. Ndër këto, ihrami është kusht, ndërsa vakfeja dhe tavafi janë rukne. Duke qenë se vakfeja e Arafatit është e kufizuar në kohë, ai që nuk e arrin kohën e caktuar atë vit nuk mund ta përfundojë atë vit haxhin dhe i duhet të presë për një herë tjetër për ta kryer detyrimin e haxhit.

Nëse tërësia e rukneve nuk zbatohet sipas mënyrës dhe kushteve të përcaktuara, haxhi nuk është i vlefshëm as me forma shlyerjeje apo kefareti.

Më sipër është shpjeguar, gjithashtu, se ihrami është ndër kushtet e vlefshmërisë apo të saktësisë së haxhit. Tani le të kalojmë në dy rukne të haxhit, siç janë vakfeja e Arafatit dhe tavafi i vizitës.

VAKFEJA E ARAFATIT

Vakfeja e Arafatit (qëndrimi në Arafat), që është një ndër ruknet pa kryerjen e të cilave haxhi nuk mund të kryhet, bëhet në zonën e Arafatit, që ndodhet afro 25 km në jugperëndim të Mekës dhe me kufijtë e shënjuar jashtë zonës së Haremit.

Vakfe do të thotë të ndalesh e të presësh për njëfarë kohe në një vend të caktuar. Thënia e Profetit tonë (a.s.), sipas të cilit "Haxhi përbëhet prej Arafatit",[11] tregon se sa i rëndësishëm është për haxhin ndalimi në Arafat dhe se sa rëndësi e vëmendje duhet t'i kushtojmë atij. Nisur nga sa më sipër, ata që gjatë haxhit humbin Arafatin, mund ta kryejnë haxhin jo më herët se një vit më pas.

Kushtet e vlefshmërisë së vakfes:

* Të gjendurit në ihram me nijetin për të kryer haxhin.

* Të kryhet vakfeja brenda kufijve të Arafatit dhe në ditën e Arafatit, në kohën nga hyrja e namazit të drekës, gjer në mëngjesin e Bajramit në "fexhri sadik", pra kur agimi ndriçon tokën (koha e hyrjes së namazit të sabahut).

11. Tirmidhi, Tefsir, 3; Ebu Davud, Menasik 68; Ibn Maxhe, Menasik, 57.

Kufiri i Arafatit në zonën e Mekës është lugina e Urenesë. Përveç kësaj lugine, vakfeja mund të bëhet në çdo vend të zonës së Arafatit. Edhe një pjesë e xhamisë së Nemirës, në anë të kibles (veriperëndim), mbetet jashtë vendit të vakfes. Ndërsa kryerja e vakfes në majën e quajtur "Xhebelu Rrahme" është sunet.

Bashkë me mbërritjen e diellit në pikën e majës në ditën e nëntë të muajit të dhilhixhes, që është dita e Arafatit, hyn koha e vakfes. Me ndriçimin e vendit prej agimit në ditën e parë të Bajramit, koha e vakfes përfundon. Në lidhje me këtë çështje studiuesit janë në njëmendje. Në mënyrë që vakfeja të jetë e vlefshme, nuk është kusht që të bëhet nijet dhe të jemi në vetëdijen e të qenit duke bërë vakfe në Arafat. Nëse brenda kufirit kohor në fjalë, pavarësisht nëse me vetëdije apo jo, në gjumë apo i zgjuar, me abdes apo jo, në çfarëdolloj gjendjeje, dikush gjendet qoftë edhe për një kohë të shkurtër brenda kufijve të Arafatit, madje edhe dikush që vetëm sa kalon në atë zonë, konsiderohet se e ka kryer vakfen e Arafatit. Ata që gjenden gjatë ditës në Arafat në ditën e Arafatit, e kanë për vaxhib që të mos largohen nga Arafati përpara perëndimit të diellit. Nëse dikush largohet prej asaj zone ende pa perënduar dielli dhe pastaj kthehet sërish para perëndimit, nuk ka nevojë të shlyejë asgjë. Në të kundërt, është e nevojshme shlyerja, apo bërja kurban e një deleje apo e një dhie.

Sunetet e vakfes së Arafatit

Në ditën e tervijes, që është dita e tetë e dhilhixhesë, pas kalimit në Mina të natës që pason ditën e Arafatit, me lindjen e diellit të lëvizet drejt Arafatit.

Të gjendemi në Arafat përpara mesditës dhe nëse është e mundur, të marrim abdes të plotë të trupit.

Pas mesditës, përpara faljes së namazit të drekës, të ligjërohet hutbe në xhaminë e Nemirës.

Namazet e drekës dhe të ikindisë të falen së bashku në kohën e drekës.

Gjatë të bërit të vakfes të jemi me abdes dhe të drejtohemi nga kibla.

Vakfeja të kryhet pasi dreka dhe ikindia të jenë falur së bashku në "xhem në avancë".

Të mos jemi në agjërim.

Gjatë ditës të angazhohemi vazhdimisht në telbije, tesbih, dhikër, lutje dhe pendesë.

Vakfeja të kryhet sa më afër vendit të njohur si maja e mëshirës apo "Xhebelu Rrahme". Gjatë kryerjes së vakfes, është më mirë të qëndrohet në këmbë sesa ulur dhe më mirë të qëndrohet mbi kafshë sesa në këmbë.

Xhemi takdim, ose xhem në avancë; është sunet që ata që bëjnë vakfenë në ditën e Arafatit të falin të bashkuar drekën me ikindinë.

Në të falurit e drekës dhe të ikindisë në "xhem në avancë", pas këndimit të ezanit falen së pari sunetet e para të drekës. Më pas, pasi të thirret ikameti, falet farzi i drekës. Sërish thirret ikamet dhe falet farzi i ikindisë. Për namazin e ikindisë nuk thirret ezan më vete dhe sunetet mes dy farzeve nuk falen. Pas secilit prej farzeve recitohen telbije dhe tekbire teshrikë.

TAVAFI I VIZITËS

Rukni i dytë i haxhit është tavafi i vizitës. Pa kryer tavafin e vizitës, haxhi nuk është i plotë. Në Kur'anin fisnik domosdoshmëria e tavafit të vizitës është shprehur në këtë mënyrë: **"Pastaj, duke prerë flokët dhe thonjtë, të largojnë papastërtitë e tyre dhe të vënë në vend detyrat e haxhit. Rreth më të vjetrit tempull të botës, Qabesë (Bejtul Atik), edhe një herë të bëjnë tavaf." (Haxh, 22/29)**

Tavaf do të thotë "të vish përqark diçkaje, të rrotullohesh". Në kontekstin e Menasikut të haxhit, tavafi nënkupton të ecurit shtatë herë rreth Qabesë, duke nisur nga këndi ku ndodhet guri "Haxherul Esved" ose nga drejtimi i tij. Secili prej rrotullimeve quhet "shavt" dhe shtatë shavte përbëjnë një tavaf.

Kushtet që tavafi të jetë i vlefshëm

Të kryerit e tavafit në kohën e tij: tavafi i zijaretit quhet edhe "tavaf ifada". Megjithëse mund të kryhet që nga koha e parë e gjer në fund të jetës, sipas Ebu Hanifes, ai duhet kryer në ditën e tretë të Bajramit, gjer në perëndim të diellit.

Nijeti: Parapërcaktimi me zemër i asaj çka synohet të bëhet. Krahas të synuarit me zemër, është mustehab, që të shprehet edhe me gojë. Të ardhurit përqark Qabesë pa nijetin e tavafit nuk përbën tavaf.

Kur bëhet nijeti për tavaf, nuk është e nevojshme të përcaktohet nëse tavafi që do të kryhet, do të jetë tavaf për kudum, për vizitë apo për umre. Mjafton të bëhet nijet i pakushtëzuar për tavaf.

Tavafi duhet të bëhet brenda Mesxhidul Haramit, rreth Qabesë (metaf). Edhe në katet e larta të mesxhidit mund të bëhet tavaf. Ndërsa jashtë Mesxhidul Haramit nuk mund të bëhet tavaf.

Të jetë kryer shumica e shavteve: sipas hanefive, të kryerit e së paku katër prej shavteve është kusht për vlefshmërinë e tavafit. Ndërsa në tavafet farz dhe vaxhib, për çdo shavt të mbetur pa kryer është e nevojshme shlyerja.

Vaxhibet e tavafit

* Të jesh me abdes. Të kryerit e tavafit duke qenë me abdes. Nëse gjatë kryerjes së tavafit abdesi prishet, merret abdes sërish dhe plotësohen shartet e mbetura të paplota.

* Mbajtja e mbuluar e zonës së auretit. Nëse një e katërta e organeve që duhen mbuluar ose më shumë se një e katërta e tyre zbulohen, është e nevojshme shlyerja.

* Tavafi të niset nga drejtimi i gurit "Haxherul Esved".

* Rreth Qabesë të bëhet tavaf duke nisur nga krahu i majtë.

* Tavafi të bëhet duke qarkulluar nga jashtë Hatimit. Duke qenë se Hatimi konsiderohet si pjesë e Qabesë, kjo është e nevojshme për të bërë tavaf nga jashtë Qabesë.

* Tavafet farz dhe vaxhib të mos plotësohen në shtatë shavte.

* Ata që kanë fuqi, ta bëjnë tavafin duke ecur.

* Pas tavafit të falet namazi i tavafit. Pas tavafit, qoftë ky farz apo sunet, në fund të çdo tavafi është vaxhib të falen dy rekat namaz i tavafit.

Sunetet e tavafit

* Pastrimi nga nexhaseti: qoftë në trup, qoftë në rroba, të mos gjenden papastërti nga ato që bëhen pengesë për vlefshmërinë e namazit.

* Fillimi i tavafit të bëhet duke u nisur prej "Haxherul Esved" ose prej drejtimit të tij nga ana e Ruknul jemanit.

* Në të filluarit e tavafit, në fund të çdo shavti, të bëhet istilam ndaj gurit "Haxherul Esved". Istilam do të thotë të përshëndesësh gurin në fjalë. Qoftë duke nisur tavafin, qoftë gjatë tavafit, sa herë mbërrijmë përpara gurit "Haxherul Esved", qëndrojmë kundrejt tij. Në formën që hyhet në namaz, ngrihen duart, bëhet tekbir dhe tehlil. Tehlil do të thotë që të shqiptohen fjalët: "La ilahe il'lallahu uahdehu la sherike leh, Lehul mulku ue lehul hamdu ue huve ala kul'li shej'in kadir." Nëse është e mundur, guri puthet ose përkëdhelet me duar. Në rastet kur gurit nuk i afrohemi dot për shkak të grumbullimeve të mëdha të njerëzve, në mënyrë që të mos shqetësohen të tjerët, ngrihen duart lart dhe duke kthyer shputat e brendshme nga ana e Qabesë, e duke i mbajtur duart gjer në lartësinë e veshëve, themi "Bismil'lahi, Allahu ekber", përshëndesim me shenja nga larg dhe më pas puthim shputën e brendshme të dorës. Kur guri "Haxherul Esved" bëhet istilam nga larg, nuk ndalemi përballë tij, por vazhdojmë ecjen.

Në kryerjen e istilamit ndaj gurit, është shumë e rëndësishme që njerëzve të tjerë të mos u shkaktohen shqetësime e shtypje. Kështu, Profeti ynë, në Haxhin e Lamtumirës, duke qëndruar mbi kafshë, e bëri gurin istilam me shkopin e tij dhe më pas puthi shkopin.[12]

Veç kësaj, i Dërguari i Allahut (a.s.) u ka tërhequr vëmendje sahabëve për këtë çështje. Ai i ka thënë Hz. Omerit (r.a.): "O Omer, ti je një njeri i fuqishëm. Duke bërë istilam Haxherul Esvedin, mos u shkakto shtypje

12. Muslim, Haxh, 257.

më të dobëtëve, duke shtyrë njerëzit. Nëse ke mundësi të shkosh e të afrohesh vetë aty pranë, shko. Nëse nuk e ke një mundësi të tillë, kur të kalosh përballë Haxherul Esvedit, bëje atë istilam nga larg dhe bëj tekbir e tehlil."[13]

Në çdo kalim, është mirë (mustehab) që të bëhet istilam edhe Ruknul jemani.

* Të bëhet remel. Me remel kuptojmë të ecurit e meshkujve me hapa vrapues, duke shkundur shpatullat e në mënyrë vallëzuese, në tri shavtet e para të tavafeve të bëra "saj". Gratë nuk është e nevojshme të bëjnë remel.

* Në tavafet që kërkojnë remel, meshkujt mund të bëjnë iztiba. Iztibaja bëhet duke kaluar nën krahun e djathtë njërën majë të copës që mbulon pjesën e trupit nga mesi e sipër dhe duke e hedhur atë mbi supin e majtë, krahu dhe supi i djathtë lihen jashtë rrobës (ridasë). Kryerja e iztibasë në të gjitha shavtet e tavafeve që kërkojnë remel është sunet. Në përfundim të tavafit, supi mbulohet sërish dhe namazi i tavafit falet me supin e mbuluar. Përveçse në ato tavafe, në të cilat mund të bëhet remel, iztibaja është mekruh.

* Kryerja e të gjitha shavteve të tavafit njëri pas tjetrit (muvalat). Gjatë tavafit, nëse lind ndonjë nevojë që pengon vijimin e tij, si këndimi i ikametit për namazin farz apo prishja e abdesit, tavafi ndërpritet dhe më pas plotësohet pjesa e mbetur.

* Meshkujt të kryejnë tavafin në hapësirën sa më pranë Qabesë që të jetë e mundur, ndërsa gratë ta kryejnë atë nga anët.

Braktisja e cilitdo prej suneteve të tavafit pa ndonjë arsye është mekruh. Po nëse braktisja ndodh, nuk është e nevojshme ndonjë shlyerje.

Kryerja e tavafit

Nga ana e Ruknul Jemanit vihet në drejtim të Haxherul Esvedit. Bëhet nijet për tavafin. Pasi thuhet "Bismil'lahi, Allahu Ekber" dhe bëhet istilam Haxherul Esvedi, niset tavafi. Gjatë tavafit bëhet tekbir dhe tehlil, recitohen salavate. Në çdo shavt përshëndetet Haxherul Esvedi. Pas rrotullimit shtatë herë, falim namazin e tavafit mbrapa Makamit të Ibrahimit, që është vendosur me qëllimin për të ruajtur të gjallë kujtimin e Hz. Ibrahimit (a.s.), dhe nëse nuk është e mundur të falemi aty, gjejmë një vend të përshtatshëm. Profeti ynë, në Makamin e Ibrahimit ka falur dy rekate namaz dhe si sure plotësuese ka recituar në to suret "Kafirun" dhe "Ihlas". Pas namazit bëhet dua.

Llojet e tavafit

Veç tavafit të vizitës (tavafi ifada), që është ndër ruknet e haxhit, ka edhe tavafe të tjera që mund të jenë farz, vaxhib, sunet dhe nafile. Sidoqoftë, të gjithë bëhen njëlloj. Një pjesë e tavafeve janë të lidhur me haxhin dhe një pjesë e tyre nuk kanë të bëjnë me haxhin.

Tavafet e lidhura me haxhin janë të mëposhtmet: Tavafi i kudumit, tavafi i vizitës, tavafi i lamtumirës. Ndërsa tavafi që bëhet në umre quhet tavaf i umres. Këto janë sqaruar në paragrafët përkatës.

Ndërsa tavafet që nuk janë të lidhura me haxhin dhe me umren janë këto:

* Tavafi nedhr. Nëse dikush është përkushtuar për të kryer tavafin, duhet ta çojë në vend nijetin e tij. Nëse është caktuar një kohë për nedhrin, kjo kohë duhet respektuar. Nëse nuk është caktuar një kohë, atëherë tavafi duhet kryer në një kohë të përshtatshme.

* Tavafi "tahijjetul mesxhid". Kur hyhet në një xhami, është sunet të falen dy rekate "tahijjetul mesxhid". Ndërsa kur hyhet në Mesxhidul Haram, për të shprehur respektin dhe për të përshëndetur mesxhidin është mustehab që të bëhet tavaf. Kjo quhet tafav "tahijjetul mesxhid", që ka kuptimin e tavafit të përshëndetjes. Tavafi që bëhet për haxh dhe për umre e zëvendëson këtë.

* Tavafi "tatavvu" (nafile). Ky është një tavaf nafile që bëhet kur gjendet rast gjatë kohës së qëndrimit në Mekë, përveç tavafeve që bëhen në lidhje me haxhin dhe umren.

VAXHIBET E HAXHIT

13. Ahmed b. Hanbel, Musned, 1/28; Beyhaki, Sunen-l Kubra, 5/80.

Krahas rukneve dhe kushteve të haxhit, janë edhe Menasikët që janë vaxhib. Me braktisjen e tyre, haxhi nuk bëhet i pavlefshëm, por braktisja pa arsye është mekruh me kahje nga harami (tahrimen mekruh). Për vaxhibet që lihen pa u kryer pa një arsye të ligjshme ose që nuk kryhen në kohë bëjnë të nevojshme shlyerjen. Vaxhibet e haxhit ndahen në dy grupe: "asli" dhe "fer'i".

Vaxhibet "asli" përbëhen gjithsej prej pesë Menasikësh (veprime që duhen kryer gjatë haxhit), që janë: saji mes kodrave Safa dhe Merva, vakfeja në Muzdelife, goditja e Shejtanit me gurë, rruarja ose shkurtimi i flokëve dhe tavafi.

Vaxhibet "fer'i" mund të radhiten në këtë mënyrë: vaxhibet e ihramit, vaxhibet e tavafit, vaxhibet e sa'jit, vaxhibet e vakfes së Arafatit, vaxhibet e Muzdelifes dhe vaxhibet e Minas. Vaxhibet "fer'i" janë shtjelluar bashkë me Menasikun me të cilin janë të lidhur.

SA'JI

Fjala "sa'j" në fjalor merr kuptimet "të vraposh, të përpiqesh", ndërsa si term ka kuptimin e vajtje-ardhjes shtatë herë mes kodrave Safa dhe Merve, që ndodhen në anën lindore të Qabesë, duke nisur nga Safaja dhe duke mbaruar në Merve me katër vajtje dhe tri ardhje. Çdo vajtje nga Safa në Merve dhe çdo kthim nga Merva në Safa quhet shavt. Largësia mes këtyre dy kodrave, që është afro 350 m, quhet "mes'a", pra vend ku bëhet sa'ji.

Në Kur'anin fisnik, rëndësia e sa'jit është theksuar përmes pohimit: "**Safa dhe Merva janë shenja të caktuara prej Allahut. Kushdo që viziton Qabenë me qëllim të haxhit ose të umres, nuk është mëkat t'i vizitojë ato të dyja." (Bekare, 2/158)**

Kushtet e vlefshmërisë së sa'jit

* Saji të bëhet pas hyrjes në ihram, pra pasi të jetë bërë nijet dhe telbije për haxhin, për umren ose për të dyja këto. Përpara hyrjes në ihram, nuk bëhet asnjëri prej Menasikëve të haxhit ose të umres. Në mënyrë që sa'ji të jetë i vlefshëm, edhe pse është kusht që të bëhet pas hyrjes në ihram, nuk është kusht që të bëhet duke qenë në ihram; pas përmbushjes së disa Menasikëve, mund të dilet nga ihrami dhe të bëhet saji. Kështu, kushdo që hyn në ihram për haxhin, përpara fexhri sadik të ditës së parë të Bajramit të Kurbanit, nëse dëshiron të bëjë sajin përpara vakfesë së Arafatit, mund të bëjë saj duke qenë në ihram. Nëse do ta bëjë këtë pas kthimit nga Arafati, e bën pa ihram. Kjo është më e mira dhe më në përshtatje me sunetin. Saji i umres është vaxhib që të kryhet në ihram. Ai që qethet pas shavtit të katërt të tavafit, konsiderohet se ka dalë nga ihrami. Umreja që ai do të bëjë pa qenë në ihram është e vlefshme, por duke qenë se ka dalë nga ihrami pa përmbushur sajin, është e nevojshme shlyerja.

* Sa'ji i haxhit të kryhet pas nisjes së muajve të haxhit. Përveç hyrjes në ihram, asnjë Menasik i haxhit nuk kryhet pa hyrë në muajt e haxhit.

* Të kryhet pas një tavafi muteber. Sa'ji në vetvete nuk është një nusuk (veprim haxhi) i pavarur më vete. Ndërsa tavafi muteber është tavaf që nuk kryhet në kushtet e të qenit xhunub, në menstruacione dhe në lehoni.

* Përmbushja e shumicës së sharteve dhe më së paku e katër prej tyre. Sipas hanefive ndër shtatë shavtet e sajit katër janë rukne dhe tri vaxhib. Ndërsa sipas medhhebeve të tjera të gjitha shavtet janë rukne.

* Sa'ji të niset nga kodra e Safasë. Nëse niset nga Merva, shavti i parë nuk është i vlefshëm.

Vaxhibet e sajit

* Sa'ji të kryhet duke ecur. Ata që nuk janë në gjendje ta kryejnë atë duke ecur, për shkak të arsyeve si sëmundja, mosha e thyer, ndonjë mangësi fizike etj., mund ta kryejnë me mjet (karrocë).

* Plotësimi i sa'jit me shtatë shavte.

Sunetet e sajit

* Tavafi dhe saji të bëhen njëri pas tjetrit.
* Saji të bëhet me abdes.
* Në trup e në rroba të mos gjendet ndonjë pastërti që pengon namazin.
* Të përshëndetet Haxherul Esvedi përpara nisjes së sajit.
* Në çdo shavt të bëhet ngjitja gjer në vendet ku duken Safa, Merva dhe Qabeja.
* Shavtet të bëhen njëri pas tjetrit.
* Meshkujt të bëjnë "hervele" duke ecur me shpejtësi e lëkundje mes shtyllave të shënjuara me ngjyrë të gjelbër.
* Gjatë kryerjes së sajit të jemi të angazhuar në tekbir, tahlil dhe dua.

Kryerja e sa'jit

Pas kryerjes së tavafit shkohet në kodrën e Safasë. Pasi përshëndetet Haxherul Esvedi, bëhet nijet për sa'jin e haxhit në qoftë haxh, ose për umren në qoftë umre duke thënë: "O Allahu im! Për kënaqësinë Tënde dua të bëj sa'j të haxhit në shtatë shavte mes Safasë dhe Mervës. Ma lehtëso dhe ma prano këtë!" Me tekbir, tehlil, dhikër dhe dua ecet drejt Mervës. Gjatë hervelesë, recitohet duaja: "O Zoti im, m'i fal mëkatet, bëj mëshirë për ne, fali mangësitë tona e na dhuro, na i fal të gjitha mëkatet që na i di, sepse Ti i di edhe ato që ne nuk i dimë. Nuk ka dyshim se Ti je më i Fuqishmi dhe më Fisniku!" Pasi kryhen shtatë shavtet me katër vajtje nga Safa te Merva dhe tri ardhje nga Merva te Safa, sa'ji është përmbushur.

Sa'ji nuk është një ibadet më vete. Ai patjetër pason një tavaf. Për haxhin dhe për umren bëhet tavaf nga një herë dhe sa'ji nuk ka nafile. Për këtë arsye, nuk bëhet pas çdo tavafi.

VAKFEJA E MUZDELIFES

Muzdelifeja është ajo zonë mes Minasë dhe Arafatit që mbetet brenda kufijve të Haremit. Në haxh, është sunet që nata mes ditës së Arafatit dhe ditës së Bajramit të kalohet në këtë zonë, ndërsa vakfeja është vaxhib.

Kushtet e vlefshmërisë së vakfes

* Të jesh në ihram me nijetin e haxhit.
* Të jetë kryer vakfeja e Arafatit.
* Të bëhet në vendin e caktuar, d.m.th. në Muzdelife. Është sunet të kryhet në Mesh'ari Haram.
* Të kryhet brenda kohës së duhur.

Koha e vakfes së Muzdelifes

Koha e vakfes së Muzdelifes është në ditën e parë të Bajramit të Kurbanit, nga fexhri sadik (agimi) gjer në lindjen e diellit.

Sikurse në vakfen e Arafatit, ata që ndodhen brenda kohës së caktuar në cilindo çast, qofshin edhe në gjumë, në gjendje të fikëti apo të zgjuar e në vetëdije, konsiderohet se e kanë bërë vakfen përkatëse.

Kur'ani fisnik tërheq vëmendjen për vakfen e Muzdelifes duke urdhëruar: **"E kur të ndaheni në Arafat nga vakfeja e të derdheni si lumë në Muzdelife, përmendeni Allahun në Mesh'aril Haram." (Bekare, 2/198).**

Pasi të jetë kaluar nata brenda kufijve të Muzdelifes, është sunet që të falet namazi i sabahut sapo të hyjë koha e tij, pas namazit të shprehen telbije, tekbir, dhikër, lutje e pendesë dhe të vazhdohet vakfeja gjersa të zbardhë, dhe pasi të zbardhë të lëvizet drejt Minasë ende pa lindur dielli.

Falja e namazeve të akshamit e të jacisë
në formën "xhemi tehir"

Për ata që kryejnë haxhin është vaxhib që në ditën e Arafatit në Muzdelife të falin namazet e akshamit e të jacisë duke i bashkuar (xhemi vonuar). Namazi i falur në këtë formë, xhemi tehir, me xhemat, mund të falet po kështu edhe në mënyrë individuale.

Nëse nuk ekziston shqetësimi se mund të dalë koha e jacisë, akshami dhe jacia nuk falen në Arafat ose në rrugë.

Qoftë në xhemi takdim, qoftë në xhemi tehir, mes dy farzeve është mekruh të falet namaz (pra të falen sunetet). Për këtë arsye, suneti i akshamit dhe suneti i parë i jacisë nuk falen. Namazi i dy vakteve falet me një ezan dhe me një ikamet. Për vaktin e jacisë nuk këndohen më vete ezan dhe ikamet.

GODITJA ME GURË E SHEJTANIT

Është hedhja nga ana e haxhinjve e disa gurëve të veçantë në ditët e Bajramit në Mina, ditën e parë vetëm në xhemren e Akabesë dhe ditët e tjera me radhë në xhemren e vogël, të mesme dhe në atë të Akabesë.

Xhemret janë tri shtylla të gurta në madhësi të ndryshme, të cilat në gjuhën popullore njihen edhe si shejtani i vogël, shejtani i mesëm dhe shejtani i madh. Goditja e tyre me gurë sipas mënyrës së caktuar bën pjesë në vaxhibet e haxhit.

Sipas pikëpamjes së përgjithshme, në ditët që goditet me gurë shejtani është sunet që nata të kalohet në Mina. Sipas një pikëpamjeje tjetër, është vaxhib që ata që nuk kanë ndonjë arsye për të vepruar ndryshe, të kalojnë në Mina pjesën më të madhe të secilës natë të këtyre ditëve. Minaja është një zonë mes Muzdelifes dhe Mekës, brenda kufijve të Haremit, në të cilën përfshihen hapësira e goditjes me gurë të shejtanit (xhemerati) bashkë me vendin ku theren kurbane.

Kushtet e vlefshmërisë së goditjes me gurë të shejtanit

* Gurët ndaj xhemreve hidhen duke u lëshuar me dorë. Hedhja e gurëve me ndonjë mjet të veçantë dhe jo me duar ose lënia e tyre mbi shemre nuk është e vlefshme.

* Sendet që hidhen mund të jenë gur, baltë e tharë dhe lëndë të ngjashme, me të cilat është e lejuar marrja e tejemumit. Nëse hidhen dru, mineral apo lëndë organike, goditja nuk është e vlefshme.

* Secili prej gurëve duhet të hidhet më vete. Nëse hidhen të gjithë njëherësh, pranohet sikur të jetë hedhur një gur i vetëm.

* Gurët duhen hedhur në vendin e caktuar, d.m.th. në shtyllën e gurtë ose në hauzin rreth saj. Gurët që nuk mbërrijnë aty nuk kanë vlerë.

* Gurët duhen hedhur në vend nga veprimi i drejtpërdrejtë i hedhësit. Nëse një gur, pasi përplaset në një vend tjetër, bie më pas në vendin e duhur, është i vlefshëm, por nëse shtyhet në vend nga dikush tjetër, duhet goditur sërish.

* Ai që i ka mundësitë t'i hedhë gurët, duhet ta bëjë vetë këtë. Që dikush të caktojë dikë tjetër si zëvendës për t'i hedhur gurët në vend të tij, duhet të jetë në një gjendje fizike, që nuk i lejon të falë namazin në këmbë.

* Gurët duhen hedhur në kohët e caktuara.

Koha e goditjes së shejtanit me gurë

Ditët e goditjes me gurë të shejtanit nisin në ditën e parë të Bajramit, që nga agimi dhe mbarojnë në ditën e katërt gjer në perëndim të diellit. Po edhe brenda këtyre ditëve ka kohë, në të cilat nuk është e lejuar të hidhen gurë. Më poshtë do të shohim me radhë se cilat janë kohët që kërkojnë ndryshim në hedhjen e gurëve brenda ditëve të Bajramit.

a. Dita e parë e Bajramit (Dita e 10 e dhilhixhes)

Në këtë ditë hidhen vetëm shtatë gurë në xhemren e Akabesë. Në ditën e parë të Bajramit koha e goditjes së shejtanit me gurë është mes mëngjesit të Bajramit nga fexhri sadiku deri në fexhri sadikun e ditës pasardhëse. Brenda kësaj kohe, hedhja e gurëve ende pa lindur dielli është mekruh; nga lindja e diellit gjer në vaktin e drekës është sunet; nga dreka gjer në perëndim të diellit është xhaiz (e lejuar); shtyrja e hedhjes së gurëve pa arsye pas perëndimit të diellit është gjykuar si xhaiz, por mekruh. Si arsye e kerahetit është pohuar fakti se gurët e hedhur në errësirë mund të mos bien në vendin e duhur ose mund t'u shkaktojnë dëm të tjerëve.

Mirëpo në ditët e sotme, për arsye të ndriçimit të mjaftueshëm, shqetësimet e sipërpërmendura nuk ekzistojnë më. Përveç kësaj, duke qenë se gjatë ditës mund të shkaktohet shtypje për shkak të numrit të madh të njerëzve dhe rreziku i shtypjes mund të gjykohet si një arsye e pranueshme, nuk duhet të përbëjë problem hedhja e gurëve natën (Allahu e di më së miri).

b. Dita e dytë dhe e tretë e Bajramit (dita e 11 dhe e 12 e dhilhixhes)

Në ditën e dytë dhe të tretë të Bajramit secila shemre goditet me nga shtatë gurë. Në këto ditë hedhja e gurëve nis me mesditën dhe vazhdon gjersa në ditën pasardhëse të agojë. Në këto ditë nuk është e lejuar të hidhen gurë përpara mesditës.

c. Dita e katërt e Bajramit (Dita e 13 e dhilhixhes)

Sipas Imam Ebu Hanifes, në ditën e katërt të Bajramit koha e hedhjes së gurëve nis me agimin. Brenda kësaj kohe, hedhja e gurëve para lindjes së diellit është mekruh, nga lindja e diellit deri në mesditë është xhaiz dhe pas mesditës është sunet.

Në ditën e katërt të Bajramit, bashkë me perëndimin e diellit, koha e hedhjes së gurëve, qoftë në drejtim të të kryerit brenda edasë, qoftë në të kryerit si kaza, merr fund.

Vekaleti në goditjen e shejtanit

Njerëzit që nuk janë në gjendje të hedhin vetë gurët për arsye si sëmundja, mosha e madhe apo mangësitë fizike, duhet të zgjedhin si vekil (përfaqësues) dikë tjetër, që mund ta bëjë këtë. Masa e arsyes që kjo të jetë e pranueshme është pamundësia për të falur namazin në këmbë. Ata që, për shkak të grumbullimit të madh të njerëzve, nuk arrijnë t'i hedhin gurët gjatë ditës, mund t'i hedhin ata gjatë natës në kohë kur nuk ka grumbullime aq të mëdha.

Ata që kanë mundësi që t'i hedhin vetë gurët gjatë netëve nuk është xhaiz që të lënë vekalet e të caktojnë të tjerë për këtë. Që vekaleti të jetë i lejuar, duhet që pamundësia fizike të jetë e qëndrueshme.

Ata që caktohen si vekilë fillimisht hedhin gurët e vet në çdo shemre e më pas hedhin gurët e atyre për të cilët janë caktuar vekilë.

Kazaja e gurëve që s'janë hedhur në kohën e vet

Për gurët që s'janë hedhur dot në kohën e duhur, është vaxhib që hedhja e tyre të bëhet kaza. Koha e hedhjes së gurëve përfundon në ditën e katërt të Bajramit bashkë me perëndimin e diellit. Pas kësaj, hedhja e gurëve nuk kryhet më as brenda edasë, as kaza.

Hedhja nëpër xhemre e më shumë gurëve nga sa është e lejuar është mekruh.

QETHJA E PLOTË OSE SHKURTIMI I FLOKËVE

Qethja e plotë e flokëve brenda kohës së haxhit ose të umres (me brisk ose me makinë) ose shkurtimi i tyre është ndër Menasikët e konsideruar vaxhib.

Në ajetin e shenjtë kur'anor është urdhëruar e thënë: **"Pas kësaj, të presin flokët dhe thonjtë e tyre, të largojnë papastërtitë nga trupi e nga koka dhe të vënë në vend detyrat e tjera të haxhit." (Haxh, 22/29)**

Sipas transmetimi të Hz. Enesit (r.a.), "I Dërguari i Allahut (paqja qoftë mbi të) erdhi në Mina, shkoi e goditi me gurë shejtanin, pastaj erdhi në vendin që ndodhet në Mina dhe theri kurban. Pas kësaj i tha berberit "Më qeth", duke i treguar së pari anën e djathtë e më pas të majtën. Pastaj, ata flokë të bekuar që u prenë ua ndau atyre që kishte përreth."[14]

Koha e qethjes

Sipas Ebu Hanifes koha e qethjes janë ditët e Bajramit të Kurbanit, ndërsa vendi është zona e Haremit. Sipas tij ai që nuk pret flokët në ditët e Bajramit të Kurbanit ose jashtë zonës së Haremit duhet të therë kurban, sepse Profeti (paqja qoftë mbi të) i ka prerë flokët në ditët e Bajramit të Kurbanit dhe brenda kufijve të Haremit. Për këtë arsye, vonimi i këtij veprimi përbën vonim të një vaxhibi dhe shtyrja e vaxhibit kërkon shlyerje përmes therjes së kurbanit.

Kushdo që qethet në çfarëdo kohë në mëngjesin e Bajramit, duke përfshirë fexhri sadikun, llogaritet se ka dalë nga ihrami. Po nëse nuk është qethur, nuk ka dalë nga ihrami.

Masa e detyruar (vaxhib) e flokëve për t'u qethur, sikurse në rastin e kryerjes së mes'hit të abdesit, është së paku një e katërta e kokës. Nëse kemi flokë vetëm në një të katërtën e kokës apo më pak, atëherë ajo masë duhet qethur e gjitha. Sado flokë që të ketë, prerja apo qethja e të gjithë flokëve është sunet. Për meshkujt, rruajtja e plotë e flokëve është më e mirë sesa shkurtimi, ndërsa gratë presin së paku një të katërtën e flokëve në majat e tyre. Qethja e plotë e flokëve nga ana e tyre është mekruh. Në rast të shkurtimit të flokëve, masa e prerjes nuk duhet të jetë më e vogël sesa gjatësia e majës së gishtit.

Radha mes qethjes dhe Menasikëve të tjerë

Profeti (paqja qoftë mbi) të kur mbërriti për Haxhin e Lamtumirës në ditën e parë të Bajramit të Kurbanit nga Muzdelifeja në Mina, fillimisht goditi me shtatë gurë xhemren e Akabes. Pastaj, sipas radhës, theri kurbanet dhe qethi flokët. Më pas shkoi në Mekë, bëri tavafin e vizitës dhe u kthye sërish në Mina.

Sipas Ebu Hanifes, në haxhin "temettu" dhe "kiran" goditja me gurë, therja e kurbanit dhe qethja, ndërsa në haxhin "ifrad" goditja me gurë dhe qethja është vaxhib që të kryhen duke respektuar radhën. Nëse kjo radhë nuk respektohet, është e nevojshme shlyerja. Ndërsa në tavafin e vizitës, Ebu Hanifja dhe muxhtehidët e tjerë janë në njëmendje se respektimi i radhës nuk është vaxhib, por sunet.

Sipas Imam Ebu Jusufit, Imam Muhamedit dhe muxhtehidëve të tjerë, ndjekja e radhës është sunet. Edhe pse mosrespektimi i radhës përbën mekruh, shlyerja nuk është e nevojshme.

Nëse veprohet duke u mbështetur në ixhtihadin e Ebu Hanifes dhe respektohet radha, ata që bëjnë haxh "ifrad" pasi të hedhin gurët dhe ata që bëjnë haxh "temettu" ose "kiran" pasi të hedhin gurët në xhemren e Akabes dhe të therin kurbanet, qethen dhe dalin nga ihrami.

Ata që do qethen për të dalë nga ihrami mund t'i presin flokët vetë ose mund të qethen nga të tjerë. Pa prerë flokët, nuk i kryejnë dot veprimet dhe sjelljet që janë të ndaluara për ata që është në ihram.

Hukmi (gjykimi) i qethjes ose i shkurtimit të flokëve

Haxhiu që qeth ose shkurton flokët del nga ihrami. Dalja nga ihrami mundëson që sërish të vishen rroba, të përdoret parfum dhe të priten flokët, mjekra e mustaqet etj., që ishin të ndaluara në ihram. Shfuqizimi i ndalimeve të ihramit quhet "tahalul". Tahaluli kryhet në dy faza. Shfuqizimi në haxh i të gjitha ndalimeve përveç ndalimit të marrëdhënies seksuale quhet "tahaluli i parë", ndërsa shfuqizimi i ndalimit edhe për marrëdhënieve seksuale përbën "tahalulin e dytë".

14. Muslim, Haxh, 86, Fedail, 75.

a. Tahaluli i parë

Tahaluli nënkupton, krahas përfundimit të ndalimeve të ihramit, daljen nga ihrami. Tahaluli i parë, që siguron shfuqizimin e ndalimeve të ihramit përveç marrëdhënies seksuale, realizohet vetëm me qethjen ose shkurtimin e flokëve. Për këtë arsye, nëse dikush që ka goditur me gurë xhemren e Akabes, ka therur kurban dhe ka kryer tavafin e vizitës, nëse nuk është qethur ende, nuk ka dalë nga ihrami. Por nëse dikush, ende pa bërë asnjërën nga këto, ka prerë flokët, ai ka dalë nga ihrami me tehalulin e parë dhe për të, përveç marrëdhënies seksuale, të gjitha ndalimet e tjera shfuqizohen. Ndërsa pa prerë flokët, duke bërë tavafin e vizitës, nuk dilet nga ihrami as nëpërmjet tehalulit të vogël, as nëpërmjet tehalulit të madh.

b. Tehaluli i dytë

Me tehalulin e dytë, të gjitha ndalimet, përfshirë edhe marrëdhënien seksuale, shfuqizohen. Tehaluli i dytë bëhet pas të parit, me kryerjen e tavafit të vizitës, që është rukni i dytë i haxhit.

TAVAFI I LAMTUMIRËS

Tavafi i lamtumirës është Menasiku i fundit i haxhit. Haxhinjtë që llogariten si "afaki", që nuk banojnë brenda kufijve të mikatit dhe që vijnë nga larg, përpara se të kthehen në vendet e veta, është vaxhib që të kryejnë tavafin e lamtumirës. Ky quhet ndryshe edhe "tavaf i saderit", që do të thotë "tavafi i ndarjes".

Kushtet e të qenit vaxhib

Që për dikë të jetë vaxhib tavafi i lamtumirës, ai duhet:

Të ketë kryer haxhin;

Të jetë afaki (nuk është vaxhib për ata që banojnë brenda kufijve të zonës së Haremit)

Gratë, në kohën që do të largohen nga Meka, duhet të jenë të pastruara prej hajzit dhe nifasit. Gratë që hyjnë në gjendjen menstruale pa e kryer tavafin e lamtumirës dhe do të largohen nga Meka pa u pastruar, nuk e kryejnë tavafin e lamtumirës.

Koha dhe kushti i vlefshmërisë së tavafit të lamtumirës

Tavafi i lamtumirës bëhet pas tavafit të vizitës. Pa dalë nga Meka dhe pa e kaluar kufirin e mikatit, koha e tij nuk përfundon.

Tavafi i lamtumirës është më mirë të kryhet pranë kohës së largimit nga Meka, por lejohet të kryhet edhe më herët. Nëse është kryer më herët, nuk është e nevojshme të përsëritet përpara largimit nga Meka. Pas kryerjes së tavafit të lamtumirës, nuk ka ndonjë të keqe nëse shkohet në Haremi Sherif dhe falet namaz ose bëhet tavaf. Në këtë rast, tavafi i fundit llogaritet si tavafi i lamtumirës.

SUNETET DHE ETIKA E HAXHIT

Krahas farzeve dhe vaxhibeve, haxhi ka edhe sunetet e veta. Përmbushja e suneteve e rrit sevapin dhe mirësinë e haxhit, ndërsa braktisja e tyre me dashje dhe pa ndonjë arsye është mekruh. Sidoqoftë, braktisja e suneteve nuk mbart nevojën e ndonjë shlyerje.

Profeti (paqja qoftë mbi të) në të vërtetë na e ka shpjeguar se si duhet kryer haxhi në kohën e tij dhe ka urdhëruar e thënë: "Menasikun e haxhit mësojeni prej meje, bëni siç bëj unë."[15] Ndaj edhe një haxh i plotë e i përsosur është i mundshëm vetëm përmes përmbushjes së suneteve.

15. Buhari, Umre, 11, Haxh 32; Muslim, Haxh 154.

Sunetet e haxhit ndahen në "sunete asli" (Menasikë të pavarur e më vete) dhe në "sunete fer'i" (të lidhura me Menasikë të tjerë farz ose vaxhib). Duke qenë se sunetet "fer'i" janë shpjeguar bashkë me Menasikët përkatës, këtu do të ndalemi vetëm në sunetet "asli".

SUNETET E HAXHIT

a. Tavafi i kudumit

Kudum ka kuptimin "ardhje" apo "mbërritje". Tavafi i kudumit ka kuptimin e tavafit të mbërritjes në Mekë. Ai është sunet për ata afakinj që vijnë nga jashtë kufijve të mikatit dhe që do të kryejnë haxhin "ifrad" ose "kiran".

Ata që nuk janë afakinj, ata që kryejnë umre ose haxh "temettu", ata që, pavarësisht se kryejnë haxh "ifrad", ngjiten në Arafat pa shkuar në Mekë, për shkak të gjendjes së veçantë që paraqesin, nuk është e nevojshme të kryejnë tavafin e kudumit. Koha e tavafit të kudumit shtrihet që nga mbërritja në Mekë gjer në vakfen e Arafatit. Me kryerjen e vakfes së Arafatit, koha e tavafit të kudumit merr fund.

b. Hutbet e haxhit

Gjatë haxhit mbahen tri hutbe. E para mbahet në ditën e 7 të dhilhixhes, në Haremi Sherif, përpara namazit të drekës; e dyta në ditën e Arafatit, në Arafat, pas mesditës, në xhaminë e Nemirës, përpara faljes në "xhemi takdim" të namazeve të drekës e të ikindisë; dhe e treta në ditën e dytë të Bajramit përpara namazit të drekës, në xhaminë e Hajfës në Mina.

c. Të kalohet nata e Arafatit në Mina

Është sunet që në ditën e Tervijes, pra në ditën e 8 të dhilhixhes, pas lindjes së diellit, haxhinjtë të nisen drejt Minasë, që nga namazi i drekës së asaj dite gjer në namazin e sabahut të ditës së Arafatit, duke e përfshirë edhe këtë të fundit, të pesë vaktet t'i falin në kohën e tyre në Mina dhe pasi ta kalojnë natën në Mina, me lindjen e diellit në ditën e Arafatit, të vihen në udhë për në Arafat.

d. Të kalohet nata e Bajramit në Muzdelife

Është sunet që në ditën e Arafatit, pas perëndimit të diellit, haxhinjtë të zhvendosen dhe ta kalojnë natën në Muzdelife dhe pas namazit të sabahut, me ndriçimin e mjedisit përreth, që këtej të shkojnë për në Mina.

e. Në ditët e Bajramit të qëndrohet në Mina

Është sunet që në ditët e Bajramit, pra në ditën e 10, të 11 dhe të 12 të dhilhixhes, të qëndrohet në Mina dhe të kalohet nata atje. Madje sipas disa mendimeve të ndryshme, kjo përbën vaxhib.

f. Çlodhja në Muhassab

Është sunet kifaje që në përfundim të haxhit, duke u kthyer nga Minaja, në hyrje të Mekës, pranë Xhennetul Mualasë, në luginën e quajtur "Muhassab", të bëhet një ndalesë çlodhjeje për njëfarë kohe. Kjo formë çlodhjeje quhet "tahsib". Duke qenë se në ditët e sotme kjo luginë është përfshirë brenda Mekës, ky sunet tashmë nuk gjen zbatim.

ETIKA E HAXHIT

Ibadeti i haxhit duhet të kryhet me të ardhura të fituara në rrugë hallall.
Ata që kanë shkelur të drejtën e dikujt, duhet t'ia kthejnë të drejtën atij që i takon dhe t'i kërkojnë falje.
Duhet bërë pendesë për mëkatet e kryera, me vullnetin dhe vendosmërinë për të mos iu rikthyer më atyre.

Ibadetet e pakryera, me aq sa është e mundur, duhen përmbushur e kryer kaza.
Duhet marrë njohuri për udhëtimin e haxhit tek ata që kanë njohuri për të.
Duhen reshtur e shmangur sjelljet e mendjemadhësisë, të të dukurit e të kryelartësisë dhe duhet ruajtur thjeshtësi e pastërti.
Duhen zgjedhur shokë udhëtimi të mirë e të përshtatshëm për situatën.
Para nisjes për rrugë dhe pas kthimit në shtëpi të falen dy rekate namaz.
Përpara nisjes për në udhëtim të takohen e të përshëndeten miqtë dhe farefisnia.
Si gjatë udhëtimit, ashtu edhe gjatë haxhit, duhen shmangur debatet, fjalët e rënda dhe sjelljet fyese me të tjerët.
Koha nuk duhet kaluar me punë të kota, por me dua, me dhikër, me tesbih, me salavate dhe duke lexuar Kur'an.

UMREJA

a. Përshkrimi dhe hukmi

Umreja nuk ka një kohë të caktuar. Ajo realizohet duke hyrë në ihram sipas mënyrës së duhur dhe pas kryerjes së tavafit dhe të sajit, duke shkurtuar flokët e kështu, duke dalë nga ihrami.

Sipas këndvështrimit të përgjithshëm, është sunet muekked, që çdo mysliman që i krijohet mundësia së paku një herë në jetë të bëjë umre.

b. Farzet dhe vaxhibet e umres

Umreja ka dy farze: ihramin dhe tavafin. Ndër to, ihrami është kusht, ndërsa tavafi është rukn. Ndërsa sa'ji mes Safës e Mervës dhe prerja e flokëve janë vaxhib.

c. Koha e umres

Për të bërë umren nuk ka një kohë të caktuar. Ajo mund të bëhet në çdo kohë.

Sidoqoftë, sipas hanefive, kryerja e umres në "ditët e teshrikut", që nisin nga dita e Arafatit, gjer në ditën e katërt në perëndim të diellit, është tahrimen mekruh.

Kryerja e umres në muajin e Ramazanit është mendub dhe vlerësohet si më e mira.

d. Kryerja e umres

Ai që dëshiron të bëjë umre, pasi të hyjë në ihram në mënyrën e duhur në kufirin e mikatit në qoftë afaki ose jashtë zonës së haremit në mos qoftë i tillë, fal dy rekate namaz. Pas namazit, bën nijetin duke thënë: "O Allahu im, për kënaqësinë tënde dëshiroj të bëj umre. Lehtësoma dhe pranoma umren." Pastaj bën telbije duke shtuar: "Lebbejk, Allahumme lebbejk, lebbejke la sherike leke lebbejkk, innel hamde uen nia'mete leke uel mulk la sherike lek." Në këtë mënyrë, përmbushet nijeti i umres.

Pasi mbërrihet në Harem-i-Sherif, bëhet nijeti i tavafit duke thënë: "Allahu im, për kënaqësinë tënde dëshiroj të bëj tavafin e umres. Lehtësoma dhe pranoma tavafin." Pastaj bëhet tavafi. Në përfundim të tij, falen dy rekate namaz dhe bëhet nijeti duke thënë: "Allahu im, për kënaqësinë tënde dëshiroj të bëj sajin e umres. Lehtësoma dhe pranoje atë prej meje." Dhe bëhen katër vajtje dhe tri ardhje mes Safasë dhe Mervës duke përmbushur kështu, sa'jin e umres. Pas këtyre, rruhen ose shkurtohen flokët dhe dilet nga ihrami. Në këtë mënyrë mbyllet umreja.

Dallimi mes umres dhe haxhit është se krahas Menasikëve që kryhen në Arafat, në Muzdelife e në Mina nuk bëhet tavaf i kudumit dhe i lamtumirës. Veçanti e umres është, gjithashtu, që mund të bëhet gjatë gjithë vitit me përjashtim të ditëve të teshrikut.

LLOJET E HAXHIT

A. Llojet e haxhit në drejtim të hukmit

Në këndvështrim të hukmeve fetare, haxhi është tri lloje: farz, vaxhib dhe nafile. Për këdo që i plotëson kushtet e haxhit, është farz kryerja e haxhit një herë në jetë. Nëse dikush, për të cilin haxhi nuk është farz, vendos të kryejë haxhin, vënia në vend e këtij vendimi është vaxhib. Ndërsa haxhi i kryer jashtë farzit dhe vaxhibit është nafile. Haxhi i kryer prej fëmijëve që nuk janë të ngarkuar me detyrimin e haxhit, si dhe haxhet e kryera pas të parit janë nafile.

A është xhaiz (e lejuar) të kryhet haxh nafile?

Disa njerëz që nuk kanë asnjë lloj lidhjeje me fenë dhe me çështjet fetare pohojnë se të shkuarit në haxh është shkak për humbje të valutës, se nuk shërben për asgjë tjetër, përveçse për t'u siguruar të ardhura arabëve dhe mund të ndodhë që disa myslimanë të ndikohen nga pohime të tilla. Ndërkohë që haxhi është urdhër i Allahut. Ajo çka fitohet duke vizituar ato vende të shenjta nuk shtihet në dorë me kurrgjë tjetër. Vendin e farzit të haxhit nuk e zë asgjë. Për më tepër, ai është një ndër shtyllat themelore, mbi të cilat ngrihet Islami. Transmetohet që Imam Ebu Hanifja të ketë thënë: "Hulumtova të gjej se cili është më i miri i adhurimeve. Pasi shkova në haxh, e kuptova se më i miri adhurim qenka haxhi." Për këtë arsye, njerëzit që i kanë mundësitë, qoftë edhe për një haxh nafile, nuk është e drejtë që të pengohen prej mirësisë së asaj gurre pendese.

Krahas kësaj, dikujt që e ka kryer detyrimin e haxhit si farz, mund t'i këshillohet e t'i sqarohet se e barasvlershme me haxhin nafile, në të mirë të Islamit, është shumë e rëndësishme të bëhen dhurime vakfi, të ndihmohen nevojtarët dhe institucionet islame, nxënësit dhe studentët, etj.

B. Llojet e kryerjes së haxhit

Në drejtim të kryerjes së tij (eda), haxhi ndahet në tri lloje: ifrad, temettu dhe kiran.

HAXHI "IFRAD"

Haxhi "ifrad" është haxhi që bëhet pa umre. Duke qenë se në rastin e tij hyhet në ihram vetëm me qëllimin për të bërë haxh, i është dhënë ky emër, që mbart kuptimin e haxhit pa umre. Ata që brenda muajve të haxhit, pa bërë umre para haxhit, bëjnë nijet vetëm për haxh dhe kryejnë Menasikët e haxhit mbi këtë bazë, llogaritet se kanë bërë haxh "ifrad". Ata që kryejnë këtë lloj haxhi, pas përmbushjes së Menasikëve të haxhit, mund të bëjnë umre sa të kenë dëshirë. Qoftë afaki, qoftë brenda kufijve të mikatit, secili mund të bëjë haxh "ifrad". Për ata që bëjnë një haxh të tillë nuk është vaxhib therja e kurbanit.

HAXHI "TEMETTU"

"Temettu" do të thotë "të përfitosh, të kesh dobi". Kryhet me nijete të veçuara, duke hyrë në ihrame të veçuara për haxhin dhe për umren brenda të njëjtit vit.

Nëse pasi të jetë bërë umreja brenda muajve të haxhit dhe të jetë dalë nga ihrami, pastaj sërish brenda të njëjtit vit hyhet në ihram me nijetin për të bërë haxh dhe kryhen Menasikët e tij, haxhi i kryer është i llojit "temettu".

I është dhënë ky emërtim pasi i referohet një kohe të lirë mes umres dhe haxhit, në të cilën, për shkak të daljes nga ihrami, nuk ekzistojnë ndalesat e ihramit.

Ata që dëshirojnë të bëjnë haxh "temettu", së pari hyjnë në ihram vetëm me nijetin e umres. Pasi kryejnë umren, shkurtojnë flokët dhe dalin nga ihrami, një ditë para ditës së Arafatit, pra në ditën e tervijes, me nijetin për të bërë haxh, hyjnë sërish në ihram dhe kryejnë Menasikët e haxhit.

Ata që bëjnë haxh "temettu" duhet të therin "kurban falënderimi".

HAXHI "KIRAN"

Haxhi "kiran" bëhet duke bashkuar në muajt e haxhit të të njëjtit vit, në të njëjtin ihram, haxhin dhe umren. Duke qenë se haxhi dhe umreja mblidhen në të njëjtin ihram, i është dhënë ky emërtim, që ka kuptimin "bashkim". Afakinjtë që bëjnë një nijet të përbashkët për haxhin dhe për umren, që kryejnë umren dhe më pas, pa dalë nga ihrami, kryejnë Menasikun e haxhit me të njëjtin ihram, duke ardhur nga jashtë zonës së Hilit dhe asaj të Haremit, konsiderohet se kanë bërë haxhin "kiran".

Ata që do të kryejnë haxhin "kiran" bëjnë nijetin e umres dhe të haxhit së bashku në kufirin e mikatit dhe hyjnë në ihram. Kur vijnë në Mekë, bëjnë umre dhe presin pa dalë nga ihrami ditët në të cilat do të kryejnë Menasikun e haxhit. Pasi kryejnë haxhin me të njëjtin ihram, dalin nga ihrami.

Si në rastin e haxhit "temettu", edhe ata që kryejnë haxhin "kiran" është vaxhib që të therin "kurban falënderimi".

KUSHTET E HAXHIT "KIRAN" DHE TË HAXHIT "TEMETTU"

Ai që kryen këto lloje haxhi, duhet të jetë afaki. Ata që janë banues brenda kufijve të mikatit në zonën e Haremit dhe të Hilit, sipas këndvështrimit të përgjithshëm, nuk është xhaiz që të kryejnë haxh "temettu" dhe "kiran". Këta bëjnë vetëm haxh "ifrad".

Umreja dhe haxhi duhen kryer në muajt e haxhit të të njëjtit vit. Nëse umreja është kryer ende pa hyrë muajt e haxhit, haxhi që bëhet nuk është "temettu" ose "kiran", por "ifrad".

Pas umres së kryer në muajt e haxhit, nuk duhet të ketë "ilmam sahih". Ky i fundit realizohet duke u kthyer në atdhe pas kryerjes së umres ose duke dalë nga kufijtë e mikatit.

Këto tri lloje haxhi, për nga mirësia e tyre, renditen në këtë mënyrë:

Haxhi "kiran", haxhi "temettu" dhe haxhi "ifrad".

Mjafton që të kryhet cilido prej këtyre tri llojeve të haxhit dhe farzi i haxhit konsiderohet i përmbushur.

Nuk duhet harruar se sikurse në të gjitha ibadetet, edhe në këto mënyra të kryerjes së haxhit mirësia e vërtetë qëndron në përpjekjen, në sinqeritetin, në përkushtimin dhe në pastërtinë shpirtërore gjatë përmbushjes së tij.

KRYERJA E HAXHIT DHE E UMRES
PËRGATITJA PËR HYRJEN NË IHRAM

Menasiku i haxhit dhe i umres nis me hyrjen në ihram. Përpara hyrjes në ihram duhet bërë kujdes për pastërtinë e përgjithshme, duhen prerë thonjtë, duhen pastruar dhe hequr qimet nga sqetullat dhe nga organet gjenitale, nëse është e nevojshme, duhen shkurtuar e rregulluar flokët, mjekra, mustaqet, nëse është e mundur duhet të merret abdes i plotë i të gjithë trupit (gusël) dhe nëse nuk është e mundur, atëherë mund të merret abdes i thjeshtë.

Pas kryerjes së këtyre përgatitjeve të pastërtisë fizike, meshkujt zhveshin të gjitha rrobat e zakonshme dhe mbështillen me dy mbulesat e ihramit, të njohura si "izar" dhe "rida". Kryet e mbajnë të zbuluar dhe këmbët të zbathura. Sidoqoftë, mund të veshin edhe shapka të hapura nga sipër dhe në thembra.

Gratë nuk i ndryshojnë veshjet dhe rrobat e zakonshme. Për to nuk ka asnjë problem që të mbajnë çdo lloj rrobe a veshjeje, këpucë të mbyllura, çorape apo doreza. Sidoqoftë, ato nuk duhet të mbulojnë fytyrën.

Qoftë meshkujt, qoftë femrat, nëse nuk është koha e kerahetit në të cilën të falurit e namazit është mekruh, falin dy rekate "namaz ihrami" dhe pas kësaj, bashkë me nijetin, duke lexuar duanë "Lebbejk Allahumme lebbejk...", bëjnë telbije dhe hyjnë në ihram.

Ata që do të bëjnë haxh "ifrad", duke thënë "Allahu im, për kënaqësinë tënde dëshiroj të bëj haxhin. Ma lehtëso haxhin dhe pranoje atë prej meje", bëjnë nijet vetëm për haxhin dhe bëjnë telbije duke shqiptuar: "Lebbejk, Allahumme lebbejk, lebbejke la sherike leke lebbejkk, innel hamde uen nia'mete leke uel mulk, la

sherike lek." Ata që duan të bëjnë haxhin "temettu", bëjnë nijet vetëm për umren duke thënë "Allahu im, për kënaqësinë tënde dëshiroj të bëj umren. Ma lehtëso umren dhe pranoje atë prej meje" dhe nisin të bëjnë telbije.

Ata që duan të bëjnë haxhin "kiran", bëjnë nijetin edhe për umre, edhe për haxh dhe thonë "Allahu im, për kënaqësinë tënde dëshiroj të bëj umre dhe haxh. M'i lehtëso umren dhe haxhin dhe pranoi ato prej meje." Pastaj nisin të bëjnë telbije.

Me të shprehurit e nijetit dhe me bërjen e telbijes hyhet në ihram dhe në këtë mënyrë nisin edhe ndalimet e ihramit.

Gjer në mbërritjen në Qabe, mundohemi të shqiptojmë vazhdimisht telbije, pra "Lebbejk...", tekbir, "Allahu ekber, Allahu ekber, la ilahe il'lallahu uallahu ekber, Allahu ekber ue lil'lahil hamd", tehlil, "La ilahe il'lallahu uahdehu la sherike leh, lehul mulku ue lehul hamdu ue huve ala kul'li shej'in kadir" dhe salavati, "Allahumme sal'li ala sejjidina Muhammedin nebijjil ummijji ue ala alihi ue sahbihi ue sel'lim". Veçanërisht me ndryshimin e kohës dhe të vendit, në ngjitje, në zbritje, në takimin me grupime të tjera njerëzish, pas namazit, këto duhen shqiptuar në çdo rast.

Përsëritja e telbijes tri herë në çdo thënie dhe më pas recitimi i tekbirit, i tehlilit dhe i salavateve është mustehab. Telbija në haxh fillon në ditën e parë të Bajramit kur nis hedhja e gurëve në xhemren e Akabes, ndërsa në umre, kur mbërrijmë në derën e Haremi Sherifit ndërpritet dhe më pas nuk shqiptohet më.

Në Mekë, pas vendosjes në banesën apo në hotelin ku do të qëndrohet, merret gusël nëse është e mundur ose abdes dhe pas kësaj, duke shqiptuar telbije, shkohet në Haremi Sherif. Sapo shihet Bejtullahu, bëhet tri herë tekbir e tehlil dhe bëhen dua. Nëse nuk do të falet ndonjë farz, niset menjëherë tavafi.

TAVAFI

Në Mesxhidi Haram, në vend të namazit "tahijjetul mesxhid", që falet për përshëndetjen e xhamisë, bëhet tavafi që nis menjëherë nëse nuk do të falet ndonjë namaz farz.

Në haxhin "ifrad", së pari bëhet tavafi i kudumit, ndërsa në haxhet "temettu" dhe "kiran" bëhet tavafi i umres.

Ata që hyjnë në ihram me nijetin e haxhit të "ifradit", bëjnë nijet duke thënë: "Allahu im, për kënaqësinë tënde dëshiroj të nis tavafin e kudumit. Ma lehtëso tavafin e kudumit dhe pranoje atë prej meje" dhe pas kësaj nisin tavafin. Në kthimin nga Arafati, nëse sajin e haxhit që kryhet pas tavafit të vizitës duan ta kryejnë pas tavafit të kudumit, në këtë tavaf bëhen iztiba dhe remel.

Iztibaja, gjatë kohës që jemi në ihram, është lënia zbuluar e supit të djathtë dhe mbështjellja e rrobës së ihramit nën sqetullën e djathtë.

Remeli është të ecurit e shpejtë me hapa vrapues e triblues në tri shavtet e para të tavafit.

Nëse pas tavafit të kudumit nuk do të bëhet saji i haxhit, nuk bëhen iztiba dhe remel. Në përfundim të tavafit, nëse gjendet një vend i përshtatshëm, falen dy rekate namaz i tavafit nga pas Makamit të Ibrahimit dhe nëse ka shumë njerëz, atëherë kjo bëhet në një vend tjetër. Pas këtij namazi bëhet duaja e tavafit dhe është sunet që haxhiu të pijë ujë zemzemi.[16] Me këtë rast është e preferuar kjo lutje:

"اللَّهُمَّ إِنِّي أَسأَلُكَ عِلْمًا نَافِعًا وَ رِزْقًا وَاسِعًا وَ شِفَاءً مِنْ كُلِّ دَاءٍ وَ سَقَمٍ بِرَحْمَتِكَ يَا أَرْحَمَ الرَّاحِمِيْنَ"

"O Allah, kërkoj prej Teje dituri të dobishme, furnizim të gjerë, shërim nga çdo sëmundje – me mëshirën tënde, o më i Mëshirshmi i gjithë mëshiruesve!"

Ata që bëjnë haxh "temettu" dhe "kiran" kryejnë sajin e umres, ndërsa ata që bëjnë haxhin "ifrad" kryejnë sajin e haxhit nëse dëshirojnë.

16. Zemzemi është një burim uji 21 metra larg Qabesë. Ky burim është krijuar me urdhërin e Allahut (xh.sh.) për t'ia shuar etjen Ismailit (a.s.) kur ai dhe nëna e tij ishin të vetëm në shkretëtirën e Mekës. Në Zemzem ka shërim dhe pas pirjes së tij pranohet duaja (lutja).

Ata që kryejnë haxhin "ifrad", pas sajit të haxhit nuk dalin nga ihrami, por presin në ihram ditët kur do të kryhet Menasiku i haxhit.

Ata që do të bëjnë haxh "temettu", pasi në zonën e mikatit kanë bërë nijet vetëm për umren, bëjnë nijetin "Allahu im, për kënaqësinë tënde dëshiroj të bëj tavafin e umres. Më dhuro lehtësi dhe pranoje atë prej meje" dhe pastaj bëjnë tavafin e umres, falin dy rekate namaz tavafi, pinë ujë Zemzemi dhe shkojnë në kodrën e Safasë për të bërë sa'jin e umres. Pasi plotësojnë sa'jin e umres, qethen dhe dalin nga ihrami. Gjersa të bëjnë sërish nijet dhe të hyjnë në ihram në ditën e 8 të dhilhixhes (tervije), qëndrojnë në Mekë pa ihram. Me mbërritjen e asaj dite, hyjnë në ihram dhe bëjnë nijetin e haxhit. Nëse dëshirojnë, sa'jin e haxhit, që duhet bërë bashkë me një tavaf nafile në të kthyer nga Arafati, mund ta bëjnë edhe pa u ngjitur në Arafat.

Ata që bëjnë haxh "kiran", pasi kanë bërë nijet, duke hyrë në ihram në zonën e mikatit me fjalët "Allahu im, për kënaqësinë tënde dëshiroj të bëj tavafin e umres. Dhuromë lehtësi dhe pranoje atë prej meje", bëjnë tavafin e umres, falin namazin e tavafit, pinë ujë Zemzemi dhe pas kësaj shkojnë në "mes'a" për të bërë sajin e umres. Në përfundim të sajit të umres, qethen dhe dalin nga ihrami.

Pasi pushojnë pak, bëjnë tavafin e kudumit. Pasi falin namazin e tavafit, nëse dëshirojnë, mund të bëjnë menjëherë më pas sajin e haxhit. Në haxhin "temettu" dhe "kiran", duke qenë se pas tavafit të umres do të bëhet saji, në tavaf bëhen iztiba dhe remel në tri shavtet e para.

Edhe nëse bëjnë haxh "ifrad", edhe nëse bëjnë "kiran", të gjithë haxhinjtë, në ditën e 8 të dhilhixhes, largohen nga Meka dhe shkojnë në Mina ose në Arafat.

DITËT E KRYERJES SË MENASIKUT TË HAXHIT

Menasiku i haxhit kryhet mes ditës së tetë dhe ditës së trembëdhjetë të dhilhixhes. Menasiku që kryhet në këto ditë mund të përmblidhet si më poshtë:

a. Dita e tervijes (8 dhilhixhe)

Të gjithë haxhbërësit, në ditën e tervijes, që është një ditë para ditës së Arafatit, pasi kanë falur namazin e sabahut, nisen për në Mina ose për në Arafat. Nga namazi i drekës së ditës së tervijes gjer në namazin e sabahut të ditës së Arafatit, është sunet që të pesë kohët e namazit të falen në Mina dhe nata të kalohet atje e më pas, me lindjen e diellit, të bëhet zhvendosja për në Arafat.

b. Dita e Arafatit (9 dhilhixhe)

Zhvendosja për në Arafat realizohet në drekë gjer në mesditë. Pas mesditës, nëse është e mundur, merret abdes i krejt trupit (gusël). Dreka dhe ikindia falen me xhem në avancë, pra falen të dyja së bashku në kohën e drekës. Pas tyre ndalohet në vakfe. Gjer në mbrëmje koha duhet vlerësuar me telbije, tekbir, tehlil, dhikër, tesbih, dua, salavate, pendesë dhe kërkesë për falje.

Pas perëndimit të diellit, pa u falur namazi i akshamit, bëhet zhvendosja për në Muzdelife. Duke qenë se namazi i akshamit dhe ai i jacisë do të falen në "xhemi tehir" në kohën e jacisë në Muzdelife, në Arafat nuk falet namazi i akshamit. Pasi shkohet në Muzdelife, siç e thamë, falen në "xhemi tehir" namazi i vonuar i akshamit bashkë me namazin e jacisë. Namazet e bashkuara falen njëri pas tjetrit dhe mes farzeve nuk falet asnjë sunet. Në këtë vend nata kalohet duke bërë telbije, tekbir, tehlil, dua, pendesë, kërkesë për falje dhe salavate gjer në mëngjes. Gjithashtu, mblidhen edhe shtatëdhjetë gurë që do të përdoren për goditjen e xhemreve.

c. Dita e parë e Bajramit (10 dhilhixhe)

Me hyrjen e kohës së imsakut, në Muzdelife falet namazi i sabahut. Pas namazit bëhet ndalimi në "vakfen e Muzdelifes". Bëhet dua gjer në ndriçimin e plotë të krejt mjedisit përreth. Më pas bëhet nisja për në Mina.

Pas vendosjes në çadra në Mina, shkohet në xhemren e Akabes për të goditur me gurë shejtanin. Në ditën e parë të Bajramit, në xhemren e Akabesë hidhen shtatë gurë. Në çdo hedhje guri, thuhet "Bismil'lahi Allahu ekber, rexhmen li shejtani ue hizbih". Me hedhjen e gurit të parë, nuk thuhet më telbije.

Ata që bëjnë haxh "temettu" dhe "kiran", pas goditjes me gurë të shejtanit, therin kurbanet që i kanë vaxhib me kushtin që të qëndrojnë brenda kufijve të Haremit ose i therin nëpërmjet "vekaletit" apo përfaqësimit prej dikujt tjetër. Ata që bëjnë haxh "ifrad" nuk janë të detyruar të therin kurban. Nëse dëshirojnë, mund të therin kurban nafile.

Ata që bëjnë haxh "ifrad" dalin nga ihrami pasi hedhin gurë në xhemren e Akabes, ndërsa ata që bëjnë haxh "temettu" dhe "kiran" dalin pas therjes së kurbanit.

Nëse u krijohet mundësia, në të njëjtën ditë zbresin në Mekë dhe bëjnë tavafin e vizitës, ndërsa ata që nuk e kanë bërë më parë sajin e haxhit bëjnë edhe sajin e haxhit. Kryerja e tavafit të vizitës gjer në mbrëmjen e ditës së tretë të bajramit, sipas Imam Ebu Hanifes, është vaxhib, ndërsa sipas muxhtehidëve të tjerë është sunet. Kryerja e tij në ditën e parë të Bajramit mbart më shumë mirësi.

Pas kryerjes së tavafit të vizitës, kthimi në Mina dhe kalimi i natës atje në ditët e goditjes së shejtanit me gurës, sipas hanefive është sunet dhe sipas tri shkollave të tjera është vaxhib.

d. Dita e 2-të, e 3-të dhe e 4-t e Bajramit
(11, 12 dhe 13 dhilhixhe)

Në ditën e 2-të dhe të 3-të të Bajramit, pas mesditës, hidhen nga shtatë gurë sipas radhës në Xhemren e Vogël, në Xhemren e Mesme dhe në atë të Akabesë. Pas hedhjes së gurëve në Xhemren e Vogël dhe në atë të Mesme, bëhet dua. Pas hedhjes së gurëve në xhemren e Akabesë, nuk bëhet dua dhe largohemi menjëherë pas hedhjes së gurëve. Në ditën e 2-të dhe të 3-të, përpara mesditës, nuk bëhet goditje me gurë.

Në ditën e katërt të Bajramit, ata që nuk do të godasin xhemret me gurë, përpara fexhri sadikut duhet të largohen nga Minaja. Në ditën e katërt, ata që qëndrojnë në Mina duhet të hedhin nga shtatë gurë në secilën prej xhemreve. Pasi hedhin gurët, zbresin në Mekë.

Afakinjtë që vijnë nga larg, përpara se të largohen nga Meka, bëjnë tavafin e lamtumirës. Në këtë mënyrë, Menasiku i haxhit përfundon.

GJENDJA E GRAVE

Gratë e kryejnë haxhin dhe umren njëlloj si burrat, me përjashtim të çështjeve të mëposhtme:

Gratë, gjatë kohës së ihramit, mund të veshin fustan, çorape, doreza, këpucë të mbyllura, meste, çizme dhe çfarëdolloj veshjeje të zakonshme. Kryet i mbulojnë, por fytyrat nuk mund t'i mbulojnë. Sidoqoftë, nëse dëshirojnë, mund të përdorin ndonjë mbulesë që nuk ua prek fytyrat. Madje ka mendime mes dijetarëve se një veprim i tillë është mendub. Kështu, nëna e besimtarëve, Hz. Aishja (r.a.), për këtë çështje ka thënë kështu: "Ndërsa ne, bashkë me të Dërguarin e Allahut, ishim në ihram në haxh dhe pranë nesh kalonin burra të hipur mbi kafshë, njëra prej nesh lëshonte mbi fytyrë mbulesën që kishte mbi krye. Pasi ata kalonin dhe largoheshin prej nesh, e çilte sërish fytyrën."

Kur bëjnë telbije, tekbir dhe dua, nuk e ngrenë zërin.

Në tavaf nuk bëjnë iztiba dhe remel dhe në sa'j nuk bëjnë hervele.

Për të dalë nga ihrami nuk i qethin flokët e tyre, por vetëm i shkurtojnë në maja.

Nëse pranë Haxherul Esvedit ka meshkuj, nuk përpiqen të afrohen aty, por bëjnë istilam nga larg.

Nëse pas tavafit të vizitës bien në gjendjen menstruale ose në atë të lehonisë dhe në këtë gjendje largohen nga Meka, çlirohen nga detyrimi për të bërë tavafin e lamtumirës dhe nuk e kryejnë atë.

Gratë që konstatojnë gjendje të veçanta, i kryejnë të gjithë Menasikët e haxhit, me përjashtim të tavafit, duke qenë në këto gjendje. Këto gjendje të veçanta janë hajzi dhe nifasi dhe nëse për shkak të tyre tavafi i vizitës, që është farz, kryhet pas tri ditëve të para të Bajramit, nuk është e nevojshme shlyerja.

KURBANET QË THEREN NË HAXH DHE NË UMRE (HEDJ)

Rëndësia e hedjit

Kurbanët që theren në lidhje me Menasikun e haxhit dhe të umres quhen "hedj". Hedji është kurbani që në rrethanat e Menasikut të haxhit e të umres, i blatohet zonës së Qabesë dhe të Haremit. Ndërsa kurbani që theret me rastin e Bajramit quhet "ud'hije".

Në Kur'anin fisnik, për kurbanin është urdhëruar e thënë: **"...Kushdo që, gjersa të vijë haxhi, dëshiron të fitojë shpërblim duke bërë umre, le të therë një kurban që i vjen më lehtë..." (Bekare 2/196)**

TË NGARKUARIT ME KURBANIN HEDJ DHE LLOJET E HEDJIT

Për ata që kryejnë haxhin "temettu" dhe "kiran", është vaxhib që të therin hedjin "temettu" dhe "kiran".

Ndërsa ata që kryejnë haxhin "ifrad" ose vetëm umre, përveç kurbanit të shlyerjes, nuk kanë detyrimin therin kurbanin hedj. Nëse dëshirojnë të therin nafile, mund ta bëjnë.

Kurbanet hedj janë të ndarë në nafile dhe në vaxhib.

a. Hedji nafile

Ky është një kurban që megjithëse gjatë haxhit dhe umres nuk është vaxhib, theret me qëllimin për të fituar sevap.

Ata që kryejnë haxh "ifrad" ose vetëm umre, është mustehab që të therin hedjin nafile.

b. Hedji vaxhib

1. Hedji "temettu" dhe "kiran": Për ata që kryejnë haxhin "temettu" dhe "kiran", me qëllimin që të shprehin falënderimin për kryerjen e umres dhe të haxhit së bashku në të njëjtin sezon, është vaxhib që të therin këtë lloj kurbani.

2. Hedji i shlyerjes: Kurban që theret nëse njëri prej vaxhibeve të umres lihet pa kryer, nuk arrihet të kryhet në kohë, ose nëse nuk respektohen ndalimet e ihramit dhe të zonës së Haremit.

3. Hedji i ihsarit: Ata që, pas hyrjes në ihram me nijetin e haxhit dhe të umres, për pengesa të ndryshme nuk arrijnë ta kryejnë tavafin e Qabesë dhe vakfen e Arafatit, për të dalë nga ihrami duhet të therin këtë lloj kurbani.

4. Hedji i betimit (nedhr): Kurban i caktuar me betim paraprak për t'u therur në zonën e Haremit. Arsyeja e të qenit vaxhib është betimi.

VENDI DHE KOHA E THERJES SË KURBANIT HEDJ

Qofshin vaxhib, qofshin nafile, të gjithë kurbanet hedj theren brenda kufijve të zonës së Haremit. Më e mira është që kurbanet që do të theren gjer në mbrëmjen e ditës së tretë të Bajramit të theren në Mina, ndërsa ato të ditëve të tjera në Mekë.

Kurbanet hedj "temettu" dhe "kiran" theren në ditën e parë të bajramit që nga fexhri sadiku. Therja e tyre më herët nuk është xhaiz. Sipas Imam Ebu Hanifes, hedji "temettu" dhe ai "kiran" është vaxhib që të theren gjer në mbrëmjen e ditës së tretë të Bajramit, ndërsa sipas Imam Ebu Jusufit dhe Imam Muhamedit, kjo përbën

sunet. Nëse kurbani në këtë ditë, pa ndonjë arsye, lihet pa therur, sipas Imam Ebu Hanifes është e nevojshme të theren dy kurbane, njëri si kaza dhe tjetri si shlyerje.

MISHI I KURBANEVE HEDJ

Të gjithë mund të konsumojnë nga mishi i kurbaneve të falënderimit, të therura nga ata që bëjnë haxh "temettu" dhe "kiran", si dhe nga kurbanet e therura si hedj. Ndërsa nga kurbanet e therura për shlyerje apo si ihsar, të zotët e tyre dhe njerëzit që janë nën përkujdesjen e tyre nuk mund të hanë. Sikurse në rastin e kurbanit të betimit, mishi i këtyre kurbaneve u shpërndahet të varfërve.

AGJËRIMI NË VEND TË THERJES SË KURBANIT

Ata që pasi kanë bërë nijet për haxhin "temettu" dhe "kiran" dhe që pavarësisht se e kanë vaxhib therjen e kurbanit të falënderimit, për arsye të ndryshme nuk kanë gjetur mundësinë për të therur atë, agjërojnë dhjetë ditë, nga të cilat tri ditë gjatë haxhit dhe shtatë pas tij. Tri ditët e para duhet t'i agjërojnë brenda muajve të haxhit, pas hyrjes në ihram dhe para Bajramit të Kurbanit.

Pasi të agjërojnë tri ditë, nëse është e mundur që në ditët e kurbanit dhe ende pa prerë flokët të theret kurban, atëherë duhet therur kurban, pasi në kushte të tilla agjërimi nuk do të mund ta shlyejë kurbanin. Nëse një mundësi e tillë krijohet pas ditëve të kurbanit, nuk është e nevojshme të theret kurban.

Qoftë në tri ditët që agjërohen gjatë haxhit, qoftë në shtatë ditë që agjërohen pas haxhit, mbajtja e agjërimit me ndërprerje në ditë të caktuara është xhaiz, por të agjëruarit e këtyre ditëve pa ndërprerje është më i mirë.

XHINAJETET E UMRES DHE TË HAXHIT

a. Kuptimi i xhinajetit

Pasi bëhet nijet për haxh ose për umre dhe hyhet në ihram e gjer në daljen nga ihrami, kryerja e veprimeve që janë të ndaluara quhet xhinajet.

Në haxh dhe në umre, lënia e ndonjërit prej Menasikëve pa kryer pa ndonjë arsye ose shtyrja e tij konsiderohet xhinajet për shlyerje. Xhinajeti kërkon kurdoherë shlyerje. Xhinajetet në lidhje me zonën e Haremit dhe me ndalimet e ihramit qofshin me arsye, qofshin pa arsye, qofshin të vetëdijshme, qofshin të pavetëdijshme, qofshin me qëllim apo nën trysni, madje qofshin edhe nën mashtrim, në gjumë apo nga harresa, mbeten në të njëjtën vlerë dhe kërkojnë kefaret. Përveç kësaj, nëse këto xhinajete kryhen me dashje, për arsye se përbëjnë edhe mëkat, kërkojnë pendesë dhe kërkesë për fajle (tevbe dhe istigfar).

b. Shlyerja dhe kefaretet e xhinajeteve

Disa prej xhinajeteve që bëhen gjatë kryerjes së haxhit shkaktojnë prishjen e haxhit dhe përsëritjen e tij një vit më vonë, ndërsa disa të tjera kërkojnë thjesht shlyerje dhe kefaret. Sipas llojit të xhinajetit të kryer, kefaretet dhe shlyerjet mund t'i rendisim si më poshtë:

Kaza
Bedene (xhinajete që bëjnë të nevojshme therjen e një kurbani të trashë)
Dem (xhinajete që bëjnë të nevojshme therjen e një kurbani të imët, si dele apo dhi)
Sadaka (xhinajete që kërkojnë dhënien e sadakas në masën e fitres)
Tasadduk (Xhinajete që kërkojnë dhënien e sadakas në një masë më të vogël se fitreja)
Pagesë bedeli
Agjërim (xhinajete që bëjnë të nevojshme mbajtjen e agjërimit).

XHINAJETE QË E PRISHIN HAXHIN DHE UMREN DHE QË BËJNË TË NEVOJSHME KAZANË

Nëse dikush hyn në ihram me nijetin e haxhit dhe më pas, ende pa kryer vakfen e Arafatit, kryen marrëdhënie seksuale, haxhi i tij për atë vit konsiderohet i prishur dhe është e nevojshme kazaja në vitet që vijnë.

Ky haxh i prishur duhet të plotësohet, të bëhet kaza në vitet që vijnë dhe për shkak të xhinajetit të kryer është e nevojshme të bëhet kurban një kafshë bagëtie e imët.

Në Kur'anin fisnik, Zoti i Madhëruar e ka ndaluar gjatë haxhit çdo marrëdhënie seksuale duke urdhëruar: **"Haxhi është në muajt e caktuar. E kush e kryen haxhin në ata muaj, nuk duhet t'i afrohet marrëdhënies seksuale, as nuk duhet të përzihet në sjellje që janë të mëkatshme, as nuk duhet të shkaktojë zënka e grindje." (Bekare, 2/197)**

Nëse pas vakfes së Arafatit, ende pa prerë flokët e pa dalë nga ihrami, kryhen marrëdhënie seksuale, haxhi nuk prishet, por si shlyerje kërkohet të theret një "bedene" (deve ose ka) si kurban.

XHINAJETE QË BËJNË TË NEVOJSHME BËRJEN KURBAN TË BEDENESË (KAFSHË NGA BAGËTIA E TRASHË)

1. Kryerje e marrëdhënieve seksuale pas vakfes së Arafatit, ende pa shkurtuar flokët dhe pa dalë nga ihrami.
2. Kryerja e tavafit të vizitës (ifada) në gjendje xhunub.

Kryerja e tavafit me abdes është vaxhib. Kryerja e tavafit të vizitës pa abdes bën të detyruar therjen e një kurbani ("dem") nga bagëti të imëta, si dele apo dhi. Nëse cilido nga tavafet që është bërë pa abdes ose në gjendje xhunubi bëhet sërish me abdes, atëherë nevoja e shlyerjes nuk ekziston më. Përsa u përket gjendjeve të hajzit dhe të nifasit (menstruacionet dhe lehonia) te gratë, gjykohet dhe veprohet njëlloj si në rastin e gjendjes xhunub te meshkujt.

XHINAJETET QË KËRKOJNË THERJEN E KURBANIT NGA BAGËTI TË IMËTA

Këto janë xhinajetet që kanë të bëjnë me vaxhibet e haxhit dhe të umres dhe me mosrespektim të ndalimeve të ihramit. Ato ndahen në dy kategori:

a. Xhinajete në lidhje me vaxhibet e haxhit dhe të umres

Kalimi i zonës së mikatit pa ihram.

Moskryerja e krejt sa'jit ose e së paku katër shavteve të tij.

Braktisja pa arsye e vakfes së Muzdelifes.

Moskryerja e goditjes me gurë të shejtanit ose hedhja jashtë kohës së caktuar e shumicës së gurëve që duhen hedhur brenda ditës. Nëse është hedhur më shumë se gjysma, për secilin gur të mbetur pa hedhur duhet dhënë sadaka.

Moskryerja e tri shavteve të fundit ose vetëm e njërit shavt të tavafit të vizitës ose të umres.

Mosrespektimi i setri avretit në tavafet farz dhe vaxhib (tavafet e vizitës, të umres, të lamtumirës).

Kryerja e tavafeve të vizitës dhe të umres pa abdes dhe e tavafeve të kudumit dhe të umres në gjendje xhunub. Nëse tavafi bëhet sërish me abdes, shlyerja nuk është më e nevojshme. Sipas tri medhhebeve të tjera, duke qenë se pastrimi prej papastërtisë (hadethit) është kusht i vlefshmërisë së tavafit, tavafi i kryer pa abdes ose në gjendje xhunub nuk është i vlefshëm.

Në ditën e Arafatit, largimi nga Arafati para perëndimit të diellit.

Sipas Ebu Hanifes, lënia e tavafit të vizitës për ditët e Bajramit, mosrespektimi i tertibit (radha e nusukëve si hedhja e gurëve në xhemren e Akabesë, therja e kurbanit dhe prerja e flokëve).

Lënia pa kryer e së paku katër sharteve ose e tavafit të lamtumirës prej afakinjve.

Këto që u radhitën më sipër, në të njëjtën kohë, janë vaxhibet e haxhit dhe të umres. Në rast të braktisjes apo të vonimit të vaxhibit është i nevojshëm, apo therja e një bagëtie të imët si dele apo dhi.

b. Xhinajete në lidhje me ndalimet e ihramit

Qethja e flokëve ose e mjekrës në së paku një të katërtën ose heqja e plotë e qimeve të ndonjë organi tjetër.

Prerja e të gjithë thonjve në mënyrë të pjesshme apo njëherësh ose prerja e plotë e thonjve të njërës dorë ose të njërës këmbë.

Kryerja e marrëdhënieve seksuale pas tehalulit të parë (qethje dhe dalje nga ihrami), ende pa kryer tavafin e vizitës që është farz.

Kryerja e veprimeve dhe e sjelljeve që çojnë në marrëdhënie seksuale, si puthja apo përkëdhelja e bashkëshortes a e bashkëshortit me epsh.

Veshja nga ana e meshkujve gjatë gjithë një dite të plotë ose gjatë natës e rrobave (kostum, çorape, të brendshme, këpucë me thembra të mbyllura), mbulimi i kokës dhe i fytyrës... Gratë nuk i mbulojnë vetëm fytyrat. Nëse këto vishen në më pak se një ditë apo një natë, sadakaja është e mjaftueshme.

Nëse në një herë e kohë të vetme dhe në të njëjtin vend lyhen krejt flokët apo krejt mjekra me parfum, vaj, xhel dhe brilantinë ose me këna, bojë flokësh e të tjera si këto.

Nëse në një vend e në një kohë të vetme i gjithë trupi ose një gjymtyrë lyhet me parfum, vaj e të tjera si këto.

XHINAJETET QË IMPONOJNË DHËNIE TË SADAKASË SË FITRIT

Lyerja me parfum e një pjese të një organi dhe jo e krejt organit.

Prerja e një pjese të thonjve të njërës dorë ose të njërës këmbë.

Veshja e çfarëdolloj rrobe (veshje me qepje, çorape etj.) gjatë një pjese kohe më të shkurtër se një ditë ose më të shkurtër se një natë.

Hedhja e gurëve mangët në goditjen e shejtanit. Për çdo gurë më pak kërkohet shlyerje.

Mosrespektimi i setri avretit në tavafet që nuk janë farz ose vaxhib (nafile).

Kryerja e tavafit të kudumit ose të lamtumirës pa abdes.

Moskryerja e shavteve pas shavtit të katërt në tavafin e lamtumirës ose në saj. Për çdo shavt të mbetur pa kryer është e nevojshme shlyerja.

TASADDUK (XHINAJETET QË BËJNË TË NEVOJSHME DHËNIEN E SADAKASË NË MASË MË TË VOGËL SESA SADAKAJA E FITRIT)

Xhinajetet që bëjnë të nevojshme vetëm dhënien e sadakasë janë këto: nëse dikush është në ihram dhe vret një insekt a parazit që ka mbi vete ose e zë dhe e hedh përtokë apo ia tregon dikujt tjetër për ta vrarë insektin a parazitin që ka mbi vete.

Nëse dikush bën një veprim të tillë gjatë kohës që është në ihram, mund të japë sadaka në masën që ka dëshirë.

Nëse insektet e vrarë janë shumë, atëherë jepet sadaka në masën e sadakasë së fitrit. Nga ana tjetër, vrasja e një insekti në rrugë nuk është e ndaluar dhe nëse ndodh, nuk ka nevojë për shlyerje.

PAGESA E BEDELIT

Prerja apo këputja e çdo peme, bime apo bari që ka mbirë vetvetiu në zonën e Haremit, gjuetia e kafshëve në atë zonë, qoftë për dikë që është në ihram, qoftë edhe për këdo tjetër, është e ndaluar. Nëse dikush, në zonën e Haremit, dëmton, këput a pret gjelbërim, pemë apo barëra që nuk kanë pronar, atëherë ai vlerëson vlerën (bedelin) e tyre dhe ua jep si sadaka të varfërve. Nëse ato çka u përmendën janë në pronësi të dikujt, vlera e dëmit të shkaktuar duhet t'i jepet të zotit të tyre. Nëse vritet një kafshë, mishi i të cilës nuk konsumohet (si luani apo elefanti), shlyerja e caktuar për të nuk e kalon vlerën e një dhie apo deleje. Po nëse është fjala për kafshë, mishi i të cilave është i konsumueshëm, atëherë dy njerëz të drejtësisë përcaktojnë në vend vlerën e kafshës së vrarë dhe sasia në fjalë shpërndahet si sadaka. Nëse vlera e përcaktuar është më e vogël sesa sasia e sadakasë së fitrit, në vend të saj mjafton të mbahet një ditë agjërim. Nëse është në vlerë të barabartë me një kurban, ai që është përgjegjës për shkeljen është i lirë të zgjedhë. Nëse dëshiron ua shpërndan sa më shumë të varfërve që të jetë e mundur në vlerën e një sadakaje fitri dhe nëse dëshiron, mund të agjërojë nga një ditë për çdo masë të sadakasë së fitrit që është llogaritur. Ky agjërim mund të mbahet edhe në kohë të ndryshme.

Nëse kafsha nuk ka ngordhur, por është plagosur ose është dëmtuar, atëherë përcaktohet diferenca mes vlerës së kafshës në gjendje të shëndoshë dhe asaj në gjendje të dëmtuar. Nëse kafsha e dëmtuar, pas përmirësimit, nuk ka asnjë pasojë, nuk është e nevojshme ndonjë shlyerje.

Nëse kafsha e vrarë është një kafshë e stërvitur dhe e mësuar, si për shembull qen ose fajkua, të zotit i paguhet vlera duke marrë parasysh këto cilësi. Nëse nuk është një kafshë e stërvitur, vlera e saj u jepet të varfërve si sadaka.

Në zonën e Haremit, lejohet marrja vetëm e gjetheve të një peme, nëse pema nuk pëson ndonjë dëmtim nga kjo. Për këtë nuk është e nevojshme ndonjë shlyerje.

XHINAJETE QË KANË TË BËJNË ME MOSRESPEKTIM TË NDALIMEVE TË IHRAMIT ME ARSYE

Edhe nëse ndalimet e ihramit shkelen me ndonjë arsye të pranueshme, sërish shlyerja është e nevojshme. Përveç dukurive si sëmundja, apo aksidentet, që ndodhin jashtë vullnetit të njeriut, nëse, për shembull, qethen flokët apo vishen rroba, nuk është e thënë që të jetë patjetër i nevojshëm kurbani i një kafshe nga bagëtitë e imëta. Dikush që përballet me një gjendje të tillë bëhet mukhajjer (zgjedhës mes bërjes së kurbanit apo jo).

Në kohën që dëshiron vetë, agjëron tri ditë njëra pas tjetrës ose me ndërprerje.

Po ashtu, mundet edhe që t'u japë gjashtë të varfërve sadaka në masën e sadakasë së fitrit.

E nëse dëshiron, në zonën e Haremit, në një kohë që e zgjedh vetë, mund të bëjë kurban një dele ose një dhi.

VENDI DHE KOHA E KRYERJES SË SHLYERJES DHE TË KEFARETIT

Për të kryer shlyerjen e xhinajeteve të kryera në haxh dhe në umre nuk ka një kohë të caktuar. Shlyerja mund të realizohet gjer në fund të jetës, por sidoqoftë, është më mirë që mangësia e ndodhur në haxh për shkak të xhinajetit të kryer të shlyhet pa vonesë, sa më shpejt që të jetë e mundur. Krahas kësaj, nëse dikush e shtyn shlyerjen gjer në fund të jetës dhe më pas vdes pa arritur të kryejë atë, konsiderohet mëkatar. Për të shmangur këtë, u duhet lënë porosi në testament pasardhësve që ta kryejnë ata shlyerjen.

Therja e kurbaneve për shlyerjen e xhinajeteve duhet bërë patjetër në zonën e Haremit, por mishi i tyre mund t'u shpërndahet qoftë të varfërve të zonës së Haremit, qoftë të varfërve të zonave të tjera.

Për shlyerjet si sadakaja, bedeli dhe agjërimi nuk është caktuar ndonjë vend. Këto shlyerje mund të realizohen në cilindo vend që të shihet e arsyeshme.

IHSARI DHE FEVATI

a. Ihsari

Me ihsar kuptojmë humbjen për çfarëdolloj arsyeje të mundësisë për të bërë tavaf në Qabe dhe vakfe në Arafat pasi është bërë nijet për haxh dhe për umre dhe është hyrë në ihram. Nëse ekziston mundësia e kryerjes së njërës prej tyre, ihsari nuk ndodh.

Ihsari ndodh në rastet e pengimit nga armiku, të mbylljes së rrugëve për shkak të luftës, të të mbeturit pa parà, të sëmundjes, të vdekjes së mahremit që shoqëron gruan e të tjera si këto që pengojnë tavafin në Qabe dhe vakfen në Arafat. Sipas shafive, ihsari ndodh vetëm në rast të pengimit nga armiku. Dikush që hyn në ihram, vetëm pasi ka bërë haxhin dhe umren mund të dalë nga ihrami. Ai që përballet me pengesë në plotësimin e haxhit dhe të umres, del nga ihrami duke bërë "hedj të ihsarit" ose kurban të ihsarit brenda zonës së Haremit.

Haxhi dhe umreja që mbeten pa u kryer për arsye ihsari duhen bërë kaza.

b. Fevati

Fevati ka kuptimin e mosmbërritjes qoftë edhe për një kohë të shkurtër të vakfes së Arafatit në ditën e Arafatit nga dikush që ka hyrë në ihram për haxh. Nga mesdita e ditës së Arafatit, gjer në fexhri sadikun e ditës së Bajramit, dikush që nuk arrin në zonën e Arafatit me arsye apo pa arsye, konsiderohet se në atë vit e ka humbur (fevt) haxhin.

Kushdo që nuk e arrin vakfen e Arafatit, e bën haxhin kaza në vitet që pasojnë.

DËRGIMI I NJË PËRFAQËSUESI (VEKIL) NË HAXH

Ibadetet mund të vlerësohen në tri kategori: namazi dhe agjërimi vetëm fizikisht; zekati, sadakaja dhe kurbani vetëm me mall; Menasiku i haxhit, edhe fizikisht, edhe me mall. Në çfarëdolloj mënyre që të bëhet, sevapi i kryerjes së një ibadeti mund t'i dhurohet tjetërkujt.

Por a çlirohet dikush nga detyrimi i ibadeteve që janë farz ose vaxhib nëse nuk i kryen vetë këto, por cakton si përfaqësues (vekil) një tjetër që t'i kryejë në emër të tij?

Përsa u përket namazit dhe agjërimit, si ibadete që kryhen vetëm fizikisht, caktimi i përfaqësuesit, në mënyrë absolute, nuk lejohet.

Askush nuk mund të falë namaz apo të agjërojë në vend të dikujt tjetër. Kryerja me përfaqësim e ibadeteve që duhen kryer fizikisht, nuk e çliron individin nga përgjegjësia e kryerjes së tyre.

Për sa u përket ibadeteve si zekati, sadakaja apo kurbani, të cilat kryhen me mall, caktimi i një përfaqësuesi është absolutisht xhaiz. Dikush, sikurse mund t'i japë vetë zekatin apo sadakanë dhe të therë kurbanin, mund t'i kryejë këto edhe nëpërmjet dikujt tjetër.

Për sa i përket ibadetit të haxhit, që kryhet edhe fizikisht, edhe me mall, për dikë që është i përgjegjshëm, por që nuk i ka mundësitë fizike për ta kryer vetë, lejohet që të caktojë me vekalet dikë tjetër. Në të kundërt, caktimi i vekilit nuk është xhaiz.

Nëse për arsye si vdekja, mosha e madhe, lëngatat e gjata, mosgjendja e mahremëve për të shoqëruar gratë në udhëtim, nuk janë mundësitë e kryerjes së haxhit, dikush tjetër mund të dërgohet me vekalet në emër të personave që kanë arsyet në fjalë.

Ata që e kanë haxhin farz dhe që nuk mund ta kryejnë atë për shkak të arsyeve të sipërpërmendura, duhet të dërgojnë një përfaqësues (vekil) për të bërë haxhin e tyre.

Ata që, megjithëse e kanë haxhin farz, as nuk mund të shkojnë vetë dhe as nuk mund të dërgojnë përfaqësues, përpara vdekjes duhet të lënë porosi testamentare që dikush të bëjë haxhin në emër të tyre.

Në lidhje me kryerjen e haxhit me vekalet, një hadith i transmetuar nga Abdullah b. Abbasi e ndriçon çështjen si vijon: "Një grua prej fisit Hasa, në vitin e Haxhit të Lamtumirës, shkoi tek i Dërguari i Allahut, paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të, dhe e pyeti: "O i Dërguari i Allahut! Urdhri i Zotit të Madhëruar që njerëzit të kryejnë haxhin, babait tim i mbërriti në një moshë shumë të thyer, aq sa s'mund të qëndronte mbi kafshë. Nëse

unë bëj haxh në emër të tij, a i shlyhet borxhi?" I Dërguari i Allahut, paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të, iu përgjigj: "Po, i shlyhet.""[17]

KRYERJA ME PËRFAQËSIM E HAXHIT FARZ

Në mënyrë që haxhi farz i kryer nga përfaqësues (vekil) të konsiderohet i kryer, është i nevojshëm respektimi i kushteve të mëposhtme:

Ai, në emër të të cilit do të kryhet haxhi, duhet të jetë i penguar në vazhdimësi nga pamundësia për të kryer haxhin përmes pengesash si, për shembull, vdekja, plakja, sëmundja pa shpresë përmirësimi apo mosgjendja e mahremit për shoqërim në rastin e grave. Nëse para vdekjes pengesa bie dhe rilind mundësia për të kryer haxhin vetë, atëherë haxhi i kryer nga përfaqësuesi konsiderohet nafile dhe personi duhet të bëjë haxhin vetë.

Personi, në emër të të cilit shkohet në haxh, duhet ta ketë farz haxhin.

Përfaqësuesi (vekili), duke hyrë në ihram, duhet të bëjë nijetin e haxhit vetëm për personin, në emër të të cilit ka shkuar për haxh.

Për përfaqësimin (vekaletin) nuk duhet kërkuar pagesë. Haxhi është ibadet dhe ibadetet kryhen për kënaqësinë e Allahut.

Shpenzimet e të dërguarit si vekil duhet të merren përsipër nga dërguesi.

Personi, në emër të të cilit shkohet në haxh, duhet ta ketë kërkuar vetë këtë nga vekili.

Ai që dërgohet si vekil duhet ta bëjë haxhin vetë.

Ai që dërgohet si vekil duhet të respektojë dëshirën e dërguesit dhe të bëjë haxhin që i kërkon ai. Nëse i kërkohet të kryejë haxhin "ifrad" dhe ai kryen haxhin "temettu", llogaritet që të ketë kryer haxhin për vete e jo për dërguesin dhe duhet t'i kthejë shpenzimet këtij të fundit.

Nëse ai që ka porositur vajtjen në haxh në emër të tij ka përcaktuar sasinë e të hollave që do të shpenzohen dhe vendin nga do të dërgohet vekili, dëshira e tij duhet të respektohet.

Vekili, pa plotësuar Menasikun e haxhit në emër të dërguesit, nuk duhet të bëjë umre për vete.

VIZITA NË VENDPREHJEN E PROFETIT NË MEDINËN E NDRITUR

Ai që përfundon Menasikun e haxhit në Mekën e Nderuar dhe bëhet haxhi, shkon në Medinën e Ndritur dhe viziton Vendprehjen e Profetit që stolis Xhaminë e Profetit (Mesxhidu Nebevi) me kubenë e gjelbër. Kjo vizitë nuk ka lidhje me Menasikun e haxhit. Sidoqoftë, vendi i quajtur **"Huxhretus Saadet"**, ku ndodhet i varrosur i Dërguari i Allahut, paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të, është pranuar si më i nderuar se çdo anë e kënd i botës, duke përfshirë Qabenë, qiejt dhe arshin.[18]

Vizita në varrin e nderuar të Profetit tonë fisnik është vlerësuar si mendub. Ata që ua lejon gjendja financiare është vlerësuar se e kanë vaxhib ta kryejnë këtë vizitë dhe nëse nuk ekziston ndonjë arsye madhore për moskryerjen e saj, braktisja e kësaj vizite është gjykuar si një pakujdesi e madhe.

Le të lexojmë hadithet e mëposhtëm në lidhje me këtë çështje:

"Kushdo që më viziton mua pasi të jem ndarë nga jeta, është si të më ketë vizituar duke qenë në jetë."[19]

---

17. Buhari, Haxh, 1,2; Muslim, Haxh, 7/3.

18. Kamil, Miras, Tecrid Tercemesi, 4/258.

19. Ali el-Karî, Sherhu'sh-Shifa, 2/149.

"Kushdo që, duke besuar në shpërblimin e veprës, vjen të më vizitojë mua në Medinë, ai bëhet fqinji im. Në Ditën e Gjykimit do të ndërhyj për të."[20]

"Për atë që viziton varrin tim do të ndërhyj në Ditën e Gjykimit."[21]

"Përveç këtyre tri xhamive (me qëllim namazi dhe ibadeti) nuk mund të paracaktohet udhëtim për asnjë xhami tjetër. Këto janë: Mesxhidul Haram, Mesxhidu Nebevi dhe Mesxhidul Aksa."[22]

"Falja e një namazi në këtë Xhami timen, përveç Mesxhidul Haramit, është më e mirë se njëmijë namaze të falura në xhamitë e tjera."[23]

"Mes shtëpisë sime dhe minberit tim ka një kopsht prej kopshteve të Parajsës."[24]

"Kur dikush më përshëndet, i Madhi Zot ma rikthen shpirtin dhe unë, pasi marr përshëndetjen e atij njeriu, ia kthej përshëndetjen atij."[25]

Për Profetin tonë të nderuar siç është porositur respekt e nderim gjatë kohës që ishte në jetë, po ashtu duhet që ai të respektohet e të nderohet edhe pas kalimit në jetën e amshuar. Kështu, gjatë vizitës në fjalë, duhen shmangur sjelljet në kundërshtim me respektin dhe etikën.

Tani le t'i vëmë veshin melodisë së shpirtit që ka pasqyruar me gjuhën e zemrës "Raudën" ku ndodhet varri i nderuar i Profetit tonë; një shpirti që ngashërehet prej zjarrit përvëlues të dashurisë për të Dërguarin e Allahut (a.s.).

RAUDA

Rauda është e vetmja ndërtesë që na bën të ndiejmë shpirtin e qenies sonë në botë. Në marrëdhënie e lidhje zemrash me këtë ndërtesë të bekuar, brenda nesh lindin emocione të tilla të veçanta, saqë kur mendojmë për të, kur flasim për të, sikur të shpjegonim një monument përnderimi që e kemi njohur në gjithë dëlirësinë e tij, druhemi e dridhemi se mos biem qoftë edhe në gabimin më të vogël.

Meka, gjatë gjithë historisë njerëzore, me përjashtim të pak ndërprerjeve, ka qenë kurdoherë mihrabi i njerëzimit. Kjo veçanti e Mekës shkon përtej Qabesë. Dhe në këtë këndvështrim, Qabeja është mihrabi i mihrabëve. Ky mihrab i jashtëzakonshëm ka edhe minberin e vet, që – sa numri i pjesëzave elementare të trupit tonë, aq përshëndetje e selame i shkofshin Zotërisë së tij! – është edhe më i pastër se kopshtet e Parajsës; është Rauda e Dëlirë.

"Rauda" do të thotë "kopsht". Me lidhjen që ndiejnë kundrejt saj njerëzit që kanë besuar, me ndjesinë që buron prej kësaj lidhjeje, me mendimet e meditimet në shpërfaqjet që ndryshojnë vazhdimisht, brenda meditimeve për artin e shtëpisë së shenjtë, Rauda përbën një "Kopsht Parajse" që prej shumë e shumë kohësh është synuar të ndahet si me një gardh a mur.[26]

---

20. Beyhakî, Shuabu'l-Iman, 3/490; Axhlunî, Keshfu'l-hafa, 2/250.

21. Axhlunî, Keshfu'l-hafa, 2/250; Ali el-Karî, Sherhu'sh-Shifa, 2/149.

22. Tecrid Tercemesi; 4/199.

23. Muslim, Haxh 510; Tecrid Tercemesi, 4/249.

24. Buharî, Fedailu'l-Medine 11; Muslim, Haxh 502; Tecrid Tercemesi, 4/268.

25. Ebu Davud, Menasik, 96.

26. Hazîratu'l-Kuds: Një kopsht parajse përtej asaj që mund të arrijë mendimi njerëzor.

Ky vend i bekuar, në ndjenjën e nderimit dhe në përjetimin artistik, ka ndryshuar shumë e shumë herë për së jashtmi.. me tablonë e tij të jashtme është lodruar e lodruar shumë e shumë shpesh, por përsa i përket shpirtit dhe brendisë së lidhur me botën e zemrave, nuk është cenuar, nuk ka mundur të cenohet kurrgjë.

Si dyert e çela porsi zemrat e djegura nga malli drejt shpirtit të zotërisë së saj ose si kanatet e hapura prej shpirtit të saj drejt njerëzimit, Rauda e Dëlirë ka plot e plot dyer. E ndër këto dyer, ajo më me nam është "Babus selam" apo "Porta e Paqes".

Ata që hyjnë në këtë derë duke përshëndetur, përjetojnë një ndjesi e gjendje shpirtërore sikur dy hapa më tutje do t'i presë Zotëria i Zemrave, Profeti i Dashur. Ndiejnë dhe madje ndihen të përfshirë prej flladesh të larmishme.

Me dinjitetin, seriozitetin dhe fisnikërinë e të gjendurit në praninë e Profetit, mes radhëve të burrave me zemrat e dashuruara me të Vërtetin Zot, që falen, luten e përcjellin selame e përshëndetje, njëlloj sikur të ishte duke ecur në një korridor drite, duke marrë dritë, mbushur me dashuri e ndezulli hyjnore, njeriu ecën zgjuar drejt muvaxhehesë[27] me ndjesinë se në krye të çdo hapi do të përballet me të papritura që s'i rrok dot mendja. Shpirtrat e dëlirë që e mbërrijnë atë, sikur të mos i shihnin kurrgjë sytë, veç atë përkujtojnë dhe dënesen, veç me ëndrrën e shëmbëlltyrën e tij gjejnë ngushëllim. Për më tepër, pastaj, nëse ka mbërritur aty me pakufishmërinë e shpirtit, i përgatitur që më parë e në e pastë vënë kryet nëpër ëndrra mbi atë kufi.. në të vërtetë, për të përshkruar një tablo të tillë të folurit e fjalës ndalet dhe ligjërimi, veç shprehjes së dobësisë, nuk gjen dot kurrfarë fjale tjetër...

Kur njeriu mbërrin në sutren në drejtim të kibles, përballë vendprehjes së bekuar, që i ngjan më fort me një fytyrë të trishtë të buzëqeshur, përballet me qindra shpirtra të dashuruar që mundohen e përpiqen plot emocion e shpresë. Kjo klimë drite maksimalisht të gjelbër dhe të magjishme, thuajse secilit sipas shkallës së vet, i përcjell ndjesinë e të gjendurit përballë portës së një tjetër bote. E kështu, çdo shpirt i dashuruar që i qaset muvaxhehesë mbushet plot emocion sikur dy-tri hapa më tutje do të takonte më të dashurin dhe në shpirtin e tij nis të ndiejë meloditë më të bukura të dashurisë që kurrë nuk kanë parë penë e bojë.. e në këto e sipër, ato zëra klime të florinjtë, ato fjalë e ato pamje, me njëmijenjë shëmbëlltyra, ia mbështjellin të gjithë qenien dhe e tërheqin duke e mbartur në një brez të magjishëm e të përtejkohshëm. Secili që mbërrin në këtë brez, koncepton në vetëdijen e vet njëkohshëm të sotmen me të djeshmen, të djeshmen me epokën e dritës së të Lartit dhe duke ndier pështpëritjet që mbërrijnë prej kuvendit të tij, e humbet toruan...

Përballë Raudës së Dëlirë, jeta jetohet përherë si një shëmbëlltyrë e ëndërr. Thuajse çdo shpirt që nuk ia ka kthyer atij shpinën krejt, që ka pirë prej dorës së tij pijen e dashurisë, që është dehur prej saj e ka humbur arsyen, nuk do aspak të ndahet prej kësaj bote të magjishme. Këtu mendimet ndalen, shpirtrat hyjnë në ndikimin e ndjenjave dhe të gjitha zemrat i pushton dëshira për të mbërritur më të dashurin. Këtu, ëndrrat e fshehta që çelin brenda njeriut një nga një porsi lule, e bëjnë njeriun thuajse të shijojë ëndjet e kopshteve të Parajsës, këndelljet dhe paqen e amshimit. Këtu është porsi një zgjatim që nga përtej qiejve, i planifikuar e i ngritur me dorën e Fuqisë Hyjnore që nga përjetësia për të mundësuar thellimin në ëndrrat e shpirtrave, që ndez, ushqen e pështpërit ndjenjat, dëshirat, dashuritë. Këtu, ata që mund ta braktisin veten në klimën shumëngjyrëshe e të begatë të dëshirave në përmasa besimi, zhyten në ëndrra pa fund e pa anë, porsi udhëtarë të një misteri, të një të fshehte në dukje të parëndësishme[28] brenda jetës që jetojnë, që për ne shpesh mbetet e pasqaruar, por që ata i bën të ndiejnë ekzistencën e një tjetër "uni" që formëson identitetin e vërtetë të njeriut. Madje perdja me tylin e hollë të botës së të padukshmes shpohet e përshkohet dhe thelbi i njeriut, bashkë me të vërtetën e gjithçkaje, del në shesh.. Për këtë arsye, gjithsecili e ndien veten si të njësuar me botën e amshuar, përshtatet me harmoninë e jetës së përjetshme dhe e gjen veten në këndellje firdeusore.

---

27. Muvâxhehe: Gardh i hekurt që veçon e rrethon nga ana e Kibles varrin e përndritur të Profetit tonë.

28. Hafî-Ahfâ: Ndjenja njerëzore që nuk i vihet shumë në dukje rëndësia.

Ne kurdoherë e ndiejmë veten në Qabe në brezin e adhurimit, në Rauda në brezin e dashurisë e të përmallimit. Në të parën mundohemi t'i përgjigjemi me vetëdije të fshehtës së nënshtrimit, ndërsa në të dytën e përqafojmë atë me sinqeritet e besë. Këtu edhe në mos e dallofshim dot plotësisht thelbin e asaj çka ndiejmë, trazohemi në një botë ndjesish më prekëse se gjithçka prekëse, më entuziazmuese se gjithçka entuziazmuese; një botë që na deh me ëndrrën e vet, me harmoninë e veçantë dhe me magjepsjen e poezisë së vet. E kështu, me ndjesi që e kanë të pamundur shprehjen me fjalë, arrijmë të ndiejmë dëshirën për t'u përulur, përkulur e njësuar me tokën në sexhde.

Gjithmonë, mes gjenerimit të dashurisë hyjnore, jeta këtu jetohet në emocionin e mbërritjes së të dashurës, në këndelljen e shebi arusit.[29] Çdo ngashërim, çdo dënesje çliron në shpirtra drithërimën që shkakton zhurma e portës teksa i çelet mikut. Shpirti mezi e pret mbërritjen e së dashurës dhe ngashërehet; e përballë njerëzve që rrinë në këmbë, me kryet ulur e me sytë të mbyllur, që presin me respekt t'u çelen ëndrrat, porta aty çelet e aty mbyllet. Por ajo vazhdimisht ndez mall, vazhdimisht ushqen shpresë dhe kurdoherë shkon me dhembshuri...

Këtu muret, kolonat dhe kubetë që duken sikur janë stolisur me spiralet e dashurisë, madje dyshemetë, qilimat, thuajse të gjitha sendet, sjellin ndërmend në brendinë e tyre lule plot naze të kaltra, të gjelbra, të verdha, të çdo ngjyre dhe ngjajnë sikur janë çelur në përjetim të thellësive më të mëdha të bukurive...

Në të vërtetë, Vendprehja dhe Kubeja e Gjelbër, që kurdoherë mund t'i përngjasojmë me një shpirt të dëlirë, kur vihen pranë e pranë me thellësitë në botët e brendshme, në mendimet e në ndjenjat e të dashuruarve, bëhen aq të mistershme, saqë njeriu e mendon vendin ku rri sikur të ishte një copëz e shkëputur prej Parajsës.

Gjer më sot kam parë plot vende të mirësishme, të mbushura me atmosferë shpirtërore e ëndje të mistershme.. kam pasur rastin të shoh me sytë e mi plot e plot kënde të bekuara. Por ndër këta, ai që ka lënë në shpirtin tim gjurmët më të thella është vendi i Profetit (paqja qoftë mbi të; gjallofshin gjurmët e atij vendi në shpirtrat tanë në përjetësi! Zemra ime atë vend e ka përqafuar kurdoherë me mallin e një mbërritjeje në mëmëdhe; e duke e përqafuar, kurdoherë i ka thënë vetes: "Ja vendi i vendeve, një grusht dhè të të cilit nuk do ta shkëmbeja me botët mbarë!"

Këto janë ato që ndien një shpirt i pamësuar e i papërvojë. Atë çka përjetojnë ato zemra të mëdha, të bëra me krahë prej dijes e me kurorë prej dashurisë, duhet ta dëgjojmë e ta mësojmë prej tyre. Sa për mua, ajo që u mundova të them nuk është kurrgjë tjetër, veçse një përpjekje kundrejt mungesës së përvojës e të aftësisë nga ana ime, për të nxitur përpjekjet e atyre që mundohen e përpiqen... Në mundsha të bëj kaq gjë, do ta llogaris si arsye për t'u drejtuar kah Shpirti i Zotërisë së Krijesave dhe duke prekur trokitësen e portës së tij të them: "Edhe mua, o i Dërguar i Allahut..!"[30]

Është sunet që ditën e shtunë të shkohet në Kuba dhe të falen dy ose katër rekate namaz. Në lidhje me këtë, Profeti ynë ka thënë: "Kushdo që pastrohet mirë e bukur në shtëpi dhe, pasi merr abdes, pa ndonjë qëllim tjetër veç qëllimit për të falur namaz, shkon në xhaminë e Kubës, fiton shpërblim sa për kryerjen e umres."[31]

VENDET QË VIZITOHEN NË MEKE

• Mesxhidu'l-Haram: Kështu quhet ndryshe xhamia e ngritur në një sipërfaqe shumë të gjërë përreth Qabesë. Kjo xhami quhet edhe Haremu'sh-Sherif. Profeti (a.s.) thotë: "Namazi që falet brenda territorit të Mesxhidu'l-Haramit është njëqindmijë herë më i bekuar sesa çdonjëri nga namazet që falet në një xhami tjetër." (Ibn Maxhe)

29. Sheb-i Arûs: Mbërritja e lume, çasti kur i dashuri mbërrin të dashurën.

30. M. Fethullah Gülen, Zamanin Altin Dilimi, f. 191.

31. Nesai, Mesaxhid 9; Tecrid Tercemesi, 4/212.

• Qabja: Është ndërtesa e parë e ngritur në rruzullin tokësor me qëllim adhurimin e Allahut. Qabja quhet edhe Bejtullah që në shqip do të thotë "Shtëpia ku adhurohet Zoti". Allahu (xh.sh.) thotë: **"Me të vërtetë, Faltorja e parë e ngritur për njerëzit, është ajo në Bekë (Mekë), e bekuar dhe udhërrëfyese për popujt".** (Al-Imran, 96)

• Shpella Hira: Kjo shpellë ndodhet pranë Mekes në Malin Nur. Në këtë shpellë Profetit tonë i zbriti ajeti i parë i Kur'anit: **"Lexo".**

• Shpella Theur: Në këtë shpellë u strehua Profeti ynë Muhamed (s.a.s.) për tri ditë dhe tri netë gjatë rrugës së tij të emigrimit (hixhretit) për në Medine.

VENDET QË VIZITOHEN NË MEDINE

• **Mesxhidu'n-Nebevi**: Kjo është xhamia e parë që Profeti Muhamed (a.s.) ndërtoi pasi u vendos në Medine Munevere (Qyteti i Përndritshëm). Ai mori pjesë personalisht në ndërtimin e kësaj xhamie duke mbajtur qerpiç mbi supet e tij të bekuar. Në lidhje me faljen e namazit në këtë xhami Profeti ynë i dashur ka thënë: "Një namaz që falet në xhaminë time është më me vlerë se çdo namaz tjetër, me përjashtim të namazit që falet në Qabe." (Muslim)

• **Kopshti i Dlirë (Raudatu'l-Mutahara)**: Ky është vendi që gjendet varri i profetit Muhamed (s.a.s.) dhe ndodhet pikërisht nën kupolën e gjelbër të xhamisë profetike. Pranë varrit të Profetit gjenden edhe varri i Ebu Bekrit dhe ai i Omerit (radijallahu anhuma). Kur afrohemi aty përshëndesim me selam e këndojmë salavat për Profetin Muhamed (s.a.s.), sepse ai (a.s.) ka thënë: "Ata që do të më vizitojnë pas vdekjes, do të vlerësohen si të më kenë bërë vizitë kur unë kam qënë i gjallë." (Bejhaki)

• **Parajsa e Përhershme (Xhenetu'-Baki)**: Kështu quhet varreza që ndodhet në anën lindore të xhamisë profetike. Këtu janë varrosur mijëra sahabe dhe disa njerëz nga gjenerata e Profetit, e grave dhe e bijave të tij. Profeti ynë i nderuar e vizitonte shpesh varrezën Baki dhe lutej për myslimanët aty.

• **Xhamia Kuba**: Këtë xhami Profeti Muhamed (s.a.s.) e ndërtoi gjatë emigrimit të tij nga Meka për në Medine dhe është kështu xhamia e parë e ndërtuar në Islam.

• **Varrezat e Dëshmorëve të Uhudit**: Aty gjenden varret e shokëve të Profetit që ranë dëshmorë gjatë betejës së Uhudit.

• **Shtatë Xhamitë**: Janë të ndërtuara në vendet ku ndodheshin shtatoret kryesore të luftës së Hendekut, në të cilat myslimanët i falnin namazet grupe-grupe gjatë rrethimit.

• **Xhamia e dy Kibleve (Mesxhidu'l-Kibletejn)**: Këtu Profeti kur ishte duke u falur, Allahu e urdhëroi ta ndryshonte kiblën nga Jerusalemi (Mesxhidu'l-Aksa) në drejtim të Qabesë.

Allahu (xh.sh.) na mundësoftë kryerjen e përhershme të të gjithë adhurimeve tona brenda kritereve të principalitetit dhe përkushtueshmërisë!

Na e bëftë namazin, shokun e përhershëm të rrugës; agjërimin që mbajmë, mikun më të afërt; zekatin dhe ato që dhurojmë në emër të Allahut, ushqimin tonë të përjetshëm dhe Haxhin që kryejmë, mikun tonë të zemrës për në rrugën tonë drejt Ahiretit!

Zoti na bëftë të mundur të gjithë neve që të mund t'i kryejmë çdonjërin nga këto adhurime me sinqeritet, përkushtim dhe devocion!

Amin

PJESA E TRETË

LUTJET E HAXHIT

Personi që shkon në haxh, këndon lutjet e personit që del në udhëtim.

Kur hyn në ihram

1. Lebbejk-Allahume lebbejk. Lebbejke la sherike leke lebbejk. Innel-hamde uen-nia'mete leke uel-mulk. La sherike lek.

T'u përgjigja, Allahu im, t'u përgjigja! Ti nuk ke ortak! T'u përgjigja, lavdia dhe të mirat janë të Tuat, po ashtu dhe pasuria dhe pushteti! Ti nuk ke ortak!

2. Lebbejke lebbejke ue sa'dejke uel-khajre bijedejke uerr-rrabau ilejke uel amelu, lebbejke lebbejke ilahu-lhakki lebbejke.

Tu përgjigja, t'u përgjigja dhe t'u nënshtrova! E mira është në dorën Tënde, interesimi dhe adhurimi janë për Ty! T'u përgjigja, t'u përgjigja, o i Adhuruari i Vërtetë, t'u përgjigja!

Tavafi

Tavafi i Qabes fillon nga Guri i Zi. Personi që bën tavaf mes dy shtyllave, domethënë, mes Ruknu Jemanit dhe Gurit të Zi bën këtë lutje:

1. **Rabbena atina fid-dunja haseneten ue fil-ahireti haseneten ue kina adhaben-nar birahmetike ja erhamerr-rrahimin.**

Zoti ynë, jepna neve mirësi në këtë botë dhe në jetën tjetër dhe na mbro nga dënimi i zjarrit! Mëshirën Tënde lusim, o më Mëshiruesi i mëshiruesve!

Lutja e Tavafit

2. Allahumme kanni'nnij bima rezektenij ue barik lij fijhi ue-hluf ala kul-li gaibetin lij bihajr.

Allahu im, në të mirat që më favorizove, më bëj të kënaqur dhe më jep begati! Në vend të çdo gjëje që më humbet e shkon, më dhuro më të mirën dhe më të mbarën e saj!

3. La ilahe il-lallahu uahdehu la sherijke leh, lehul-mulku ue lehul-hamdu ue hue ala kul-li shejin kadir.

Nuk ka Zot tjetër veç Allahut, Ai është një, nuk ka ortak e nuk ka shok! Pushteti dhe falënderimi i përkasin vetëm Atij. Ai ka mundësi për çdo gjë!

Lutja pas tri rrotullimeve të para

4. Allahumme xhalhu haxh-xhen mebruren ue dhemben magfuren ue sa'jen meshkuren.

Allahu im, haxhin bëma të pranueshëm, mëkatin të falshëm dhe vajtje-ardhjen të pëlqyeshme!

Lutja në katër rrotullimet e fundit

5. Allahumme gfir ue-rham ua'fu amma ta'lem ue entel-ea'zul ekrem.

Allahu im, më fal, më mëshiro, m'i fal mëkatet që m'i di; pa dyshIm, Ti je i Nderuar dhe Bujar!

6. Allahumme Rabbena atina fid-dunja haseneten ue fil-ahireti haseneten ue kina adhaben-nar birahmetike ja erhamerr-rrahimin.

Allahu im, jepna neve mirësi në këtë botë dhe në jetën tjetër dhe me mëshirën Tënde na mbro nga dënimi i zjarrit, o më Mëshiruesi i mëshiruesve!

Pastaj personi bën lutjet e tjera sipas dëshirës. Pas mbarimit të tavafit, fal dy rekate, kthehet në pikën e nisjes, e përshëndet atë dhe ngjitet në kodrën Safa dhe, duke u kthyer nga Kibleja, thotë: "**La ilahe il'lallahu vahdehu la sherike leh...**", bën tekbir dhe lutet:

1. Allahumme a'simna bidinike ue tauai'jetike ue tauai'jeti resulike (a.s.) ue xhennibna hududek.

Allahu im, me fenë Tënde, me bindjen ndaj Teje dhe ndaj të dërguarit Tënd (a.s) na mbro ne dhe na largo prej harameve!

2. Allahumme xha'lna nuhibbuke ue nuhibbu melaiketek ue enbijaek ue rusulek ue nuhibbu i'badekes-salihin.

Allahu im, bëna ne nga ata që të duan Ty, engjëjt e Tu, të dërguarit e Tu, të zgjedhurit e Tu dhe robtë e Tu të mirë!

3. Allahumme habbibna ilejk ue ila melaiketik ue ila enbijaik ue rusulik ue ila i'badikes-salihin.

Allahu im, bëna ne të dashur për Ty, për engjëjt e Tu, për të dërguarit e Tu, për të zgjedhurit e Tu dhe për robtë e Tu të mirë!

4. Allahumme jessirna lil jusra ue xhenibnal u'sra uegfir lena fil-ahireti uel-ula ue xhalna min eimetil-mutekin.

Allahu im, drejtona në të lehta dhe largona nga vështirësitë! Falna në këtë botë dhe në jetën tjetër! Dhe bëna ne prijës të të devotshmëve!

5. La ilahe il-lallahu uahdehu la sherijke leh, lehul-mulku ue lehul-hamdu ue hue ala kul-li shejin kadijr.

Nuk ka Zot tjetër veç Allahut! Ai është një! Ai nuk ka ortak dhe nuk ka shok! Pasuria, pushteti dhe lavdia janë të Tij! Ai ka mundësi për çdo gjë!

6. La ilahe il-lallahu uahdehu enxheze ua'deh ue nasare abdes ue hezemel-ahzabe uahdeh, la ilahe il-lallah ue la na'budu il-la ij-jah muhlisine lehud-dine ue leu kerihel-kafirun.

Nuk ka Zot tjetër veç Allahut, Ai është një! Ai e mbajti fjalën, e ndihmoi robin e Vet, ushtritë armike i shkatërroi! Nuk ka Zot tjetër veç Allahut! Edhe sikur të mos duan mohuesit, feja është e Tij dhe ne vetëm Atë adhurojmë!

1. Allahumme inneke kulte "Ud'unij estexhib lekum**" ue inneke la tukhliful-mija'd ue innij eseluke kema hedejtenij lil-Islami en la tenzia'hu minnij hatta teteueffenij ue ena Muslim.**

Allahu im, vërtet Ti ke thënë: "Lutmuni Mua që t'ju përgjigjem!" Pa dyshim, Ti nuk nuk e shkel premtimin! Kërkoj prej Teje që, ashtu siç më drejtove te Islami, gjersa të ma marrësh shpirtin të mos më largosh nga Islami!

Mes kodrave Safa dhe Merve

2. Allahumme gfir uer-ham ue entel eazul ekrem.

Allahu im, më fal, më mëshiro se, sigurisht, Ti je më i Nderuari e më Bujari!

3. Allahumme gfir uer-ham ua'fu amma ta'lem inneke entel-eazul-ekrem.

Allahu im, më fal, më mëshiro, m'i fal mëkatet që di, se sigurisht, Ti je më i Shenjti e më Bujari!

4. Rabbena atina fid-dunja haseneten ue fil-ahireti haseneten ue kina adhaben-nar.

Zoti ynë, na jep të mira në këtë botë e në jetën tjetër dhe na mbro nga dënimi i zjarrit!

Lutja e Arafatit

Personi bën "lebbejk" dhe tekbir, pastaj lutet kështu:

5. **La ilahe il-lallahu uahdehu la sherijke leh, lehul-mulku ue lehul-hamdu ue hue ala kul-li shejin kadijr.**

Nuk ka Zot tjetër veç Allahut! Ai është një! Ai nuk ka ortak e nuk ka shok! Pasuria, pushteti dhe lavdia janë të Tij! Ai ka mundësi për çdo gjë!

6. Allahumme xha'l fi kalbi nura ue fi semi' nura ue fi basari nura.

Allahu im, jepi dritë e bukuri zemrës sime, jepi dritë e bukuri dëgjimit tim, jepi dritë e bukuri shikimit tim!

1. Allahumme shrah li sadri ue jessir li emri ue eu'dhu bike min uesauisis-sadri ue shetatil-emri ue fitnetil-kabr.

Allahu im, hapma gjoksin dhe lehtësoma punën. Mbështetem tek Ti nga lëkundjet e zemrës, nga rrëmuja e punëve dhe nga intriga e varrit!

2. Allahumme innij eu'dhu bike min sherri ma jelixhu fil-lejli ue sherri ma jelixhu fin-nehari ue sherri ma tehubbu bihi-rrijah.

Allahu im, mbështetem tek Ti nga e keqja e atyre që ngrysen e gdhihen dhe nga e keqja që sjellin erërat!

Në Vakfe

3. Allahu ekber ue lil-lahil-hamd, Allahu ekber ue lil-lahil-hamd, Allahu ekber ue lil-lahil-hamd.

Allahu është më i madhi, lavdia dhe falenderimi janë të posaçëm vetëm për Të! Allahu është më i madhi, lavdia i përket vetëm Atij! Allahu është më i madhi, falenderimi i përket vetëm Atij!

4. La ilahe il-lallahu uahdehu la sherike leh, lehul-mulku ue lehul-hamdu ue hue ala kul-li shejin kadir.

Nuk ka Zot tjetër veç Allahut! Ai është një! Ai nuk ka ortak e shok! Pasuria, pushteti dhe lavdia janë të Tij!

5. Allahumme ihdini bil huda ue nekkinij bit-takua uegfir li fil-ahireti uel-ula.

Allahu im, udhëzomë në rrugën Tënde të drejtë, më pastro me anë të devocionit dhe falmë mua në këtë botë e në jetën tjetër! Pastaj personi ul duart poshtë, hesht një farë kohe dhe duke i ngritur duart lart, lutet me përulje e përqendrim.

Në Mesh'ar-ul Haram

Personi bën tekbir, tehlil, tevhid, "lebbejk"dhe vazhdon të qëndrojë aty gjersa të zbardhë mirë.

Lutjet e Xhemres

Në xhemret e tjera veç Akabes, personi bën lutjet që dëshiron. Kur e përfundon gjuajtjen me gurë, lutet kështu:

Allahumme ixha'lhu haxhen mebruren ue dhemben magfura.

Allahu im, bëma haxhin të pranueshëm dhe bëmi mëkatet të falshme!

Duke therur kurban

Allahumme tekabbel minni ue min ummeti Muhammed (s.a).

2. Allahu im, pranoje këtë prej meje dhe prej umetit të Muhamedit (s.a.s.)

Allahu ekber (3 herë).

3. Allahu është më i madhi. (3 herë)

Allahumme minke ue ilejke bismil-lah.

4. Allahu im, kjo dhuratë është prej Teje dhe përsëri tek Ti po kthehet! Bismil'lah!